FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.qpz.gov.al

Nr.119 22 gusht 2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJK nr.21, datë 21.7.2009	Me objekt: 1. Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit, brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit të formës së prerë nr.591, datë 2.6.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. 2. Detyrimi i kryeregjistruesit të Republikës së Shqipërisë të dëmshpërblejë kërkuesin për dëmin finaciar shkaktuar nga vonesa e pagesës dhe dëmin jofinanciar në shumën 500 000 lekë, si dhe detyrimin e tij për të paguar kostot dhe shpenzimet në masën 100 000 lekë.....	5697
Vendim i GJK nr.22, datë 22.7.2009	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.1172, datë 16.10.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues.....	5700
Vendim i GJK nr.23, datë 23.7.2009	Me objekt shfuqizimin i vendimit nr.1200, datë 29.12.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; vendimit nr.469, datë 25.06.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr.389, datë 23.06.2006 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.....	5704
Vendim i GJK nr.24, datë 24.7.2009	Me objekt 1. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.01.2009 "Për cilësinë e lëndës djegëse gazoil (diezel), të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto, të nxjerrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe të tregtuar për automjete rrugore e gjeneratorë." 2. Pezullimi i zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.01.2009, deri sa vendimi përfundimtar i kësaj Gjykate të hyjë në fuqi.....	5713

Vendim i GJK nr.25, datë 24.7.2009	Me objekt a) Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.47, datë 5.06.2008 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. b) Interpretimi i nenit 150, pika 1 dhe nenit 177 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.....	5722
Vendim i GJK nr.27, datë 27.07.2009	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.752, datë 16.02.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.799, datë 7.07.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i vendimit nr.00-2006-256 (770), datë 2.06.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë	5731

VENDIM
Nr.21, datë 21.7.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar	i "	"
Kujtim Puto	Anëtar	i "	"
Petrit Plloçi	Anëtar	i "	"
Vitore Tusha	Anëtare	e "	"
Sokol Sadushi	Anëtar	i "	"
Sokol Berberi	Anëtar	i "	"
Admir Thanza	Anëtar	i "	"
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i "	"

me sekretare Blerina Çinari, në datë 11.06.2009, mori në shqyrtim mbi bazën e dokumentacionit çështjen me nr.11 Akti, që i përket:

KËRKUES: Fatmir Plaku, në mungesë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, në mungesë.

2. ZYRA E PËRMBARIMIT TIRANË, në mungesë.

OBJEKTI: 1. Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit, brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit të formës së prerë nr.591, datë 2.6.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

2. Detyrimi i kryeregjistruesit të Republikës së Shqipërisë të dëmshpërblejë kërkuesin për dëmin finaciar shkaktuar nga vonesa e pagesës dhe dëmin jofinanciar në shumën 500 000 lekë, si dhe detyrimin e tij për të paguar kostot dhe shpenzimet në masën 100 000 lekë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Xhezair Zaganjori, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuesi, Fatmir Plaku, ka punuar si regjistrues në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Berat nga dhjetori 1997 deri më janar 2006. Në datë 30.01.2006, Ministri i Drejtësisë, mbi bazën e propozimit të Kryeregjistruesit, ka nxjerrë urdhrin nr.522/1 "Për lirimin nga detyra të Fatmir Plakut dhe emërimin e një personi tjetër në vendin e tij".

Ky urdhër u ankimua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, e cila, me vendimin nr.591, datë 2.06.2006, vendosi pranimin e padisë për pjesën e dëmshpërblimit me dy muaj pagë për shkak të mosrespektimit të rregullave të njoftimit dhe rrëzimin për pjesën tjetër të padisë. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.102, datë 27.02.2007, vendosi pranimin e kërkesës për dëmshpërblimin me 6 muaj pagë për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustifikuar të kontratës dhe një muaj e gjysmë për vjetësi në punë. Detyrimet i ngarkohen kryeregjistruesit të Republikës. Vendimi ka marrë formë të prerë dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat është lëshuar urdhri i ekzekutimit nr.120, datë 13.07.2007, i cili detyron kryeregjistruesin të dëmshpërblejë kërkuesin në shumën 412.244 lekë.

Në datë 20.07.2007, kërkuesi ka depozituar në zyrën e përmbarimit Berat kërkesën për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë. Në bazë të nenit 516 të KPC, kjo zyrë vendosi transferimin e çështjes së ekzekutimit në zyrën e përmbarimit në Tiranë, pasi ajo është kompetente për ekzekutimin e vendimeve ndaj kryeregjistruesit të Republikës. Zyra e përmbarimit Tiranë i ka dërguar Kryeregjistruesit kërkesën për ekzekutim vullnetar të detyrimit, i cili nga ana e tij ka kthyer përgjigje se aktualisht nuk ka fonde dhe pritet çelja e buxhetit për vitin 2008. Pas kësaj, zyra e përmbarimit ka filluar procedurën për ekzekutimin e detyrueshëm të shumës prej 412.244 lekësh. Gjithashtu, ai me shkresat nr.799, datë 01.02.2008 dhe nr.799/3, datë 20.06.2008, i ka kërkuar Ministrisë së Drejtësisë akordimin e një fondi shtesë për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Rezulton se nuk ka pasur përgjigje të këtyre shkresave për sa është kërkuar.

Kërkuesi me datë 10.06.2009 ka paraqitur para kësaj gjykate një kërkesë të riformuluar sa i përket argumenteve në funksion të objektit të kërkesës. Ai pranon se vendimi gjyqësor i formës së prerë është ekzekutuar, por megjithatë ndihet i cenuar në të drejtën e tij për proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi ky ekzekutim nuk është bërë brenda një afati të arsyeshëm. Për këtë shkak ai kërkon:

- konstatimin e shkeljes të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit në kohë të vendimit gjyqësor të formës së prerë;

- detyrimin e kryeregjistruesit të Republikës së Shqipërisë të dëmshpërblejë dëmin në shumën 500.000 lekë, si dhe detyrimin e tij për të paguar kostot dhe shpenzimet në masën 100.000 lekë.

II

Lidhur me pretendimin për mosekzekutim të vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të kërkesës nga Gjykata Kushtetuese, me shkresën nr.814/7 Prot. datë 3.06.2009, Zyra Qendrore e RPP Tiranë e ka vënë në dijeni këtë gjykatë se me transfertën nr.104, datë 21.05.2009 ndaj kërkuesit është shlyer detyrimi i caktuar me vendim të formës së prerë nr.591, datë 02.02.2006 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat. Ky fakt nuk kundërshtohet nga kërkuesi, përkundrazi, me anë të parashtresës së tij të datës 10.06.2009, ai pranon se është ekzekutuar detyrimi i përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe pikërisht për këtë shkak kërkon ndryshimin e objektit të kërkesës duke pretenduar se ekzekutimi nuk është kryer brenda një afati të arsyeshëm, duke cenuar të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor, garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Për këtë arsye, ai kërkon edhe dëmshpërblim financiar në shumën 600 000 lekë, në total.

Lidhur me këtë pretendim të kërkuesit, Gjykata Kushtetuese ka pranuar në praktikën e saj se e drejta për të kërkuar ekzekutimin brenda një afati të arsyeshëm të një vendimi gjyqësor të formës së prerë është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ (Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.6, datë 31.3.2006 dhe nr.43, datë 19.12.2007). Shtetasit duhet të kenë të drejtë që të gëzojnë rezultatet e një procesi gjyqësor të përfunduar pa hasur në pengesa të paarsyshme dhe të pajustifikuara.

Kjo praktikë ka qenë në përputhje me jurisprudencën e vazhdueshme të GJEDNJ duke deklaruar se kërkuesit nuk duhet t'i mohohet e drejta për të përfituar nga rezultati i favorshëm i procesit gjyqësor thjesht duke u mbështetur në argumentin e pamundësisë financiare të shtetit (Shih vendimet Burdov kundër Rusisë, nr.59498, 2002 dhe Shilyayev kundër Rusisë, nr.9647/02, 6 tetor 2005). Shteti duhet të marrë përsipër detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzor, nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej inefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë të gjatë (Shih vendimet Georgiadis kundër Greqisë, 28 mars 2000, Qufaj kundër Shqipërisë, 30.03.2005).

Vonesa në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës për t'iu drejtuar një gjykate, e garantuar nga neni 6/1 i KEDNJ (Shih vendimet e GjEDNJ Hornsby kundër Greqisë, 19 marsit 1997; Romashov kundër Ukrainës, 27 korrik 2004; Shvedov kundër Rusisë, 20 tetor 2005).

Gjykata Kushtetuese, pasi shqyrtoi materialet e dosjes gjyqësore, konstaton se prej momentit të paraqitjes së kërkesës për ekzekutim të vendimit gjyqësor nga ana e kërkuesit ka pasur disa komunikime zyrtare midis zyrës së përmbarimit dhe kryeregjistruesit, nga të cilat rezulton se i vetmi shkak për moszbatim paraqitej mosçelja në kohë e fondeve për këtë qëllim nga Ministria e Drejtësisë. Duke qenë se ZRPP është organ në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, kryeregjistruesi i është drejtuar të paktën 3 herë asaj ministrie duke i kërkuar parashikimin e fondeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me palë ZRPP. Shkresa e fundit e zyrës së përmbarimit mban datën 19.11.2008, sipas të cilës, kjo zyrë i ka kryer të gjitha veprimet e parashikuara për këtë qëllim. Pra, nga ana e zyrës së përmbarimit Tiranë janë ndërmarrë të gjithë hapat konkretë proceduralë për ekzekutimin e vendimit që nga momenti i paraqitjes së kërkesës për ekzekutim nga kreditori. Madje ajo ka vendosur edhe gjobitjen e kryeregjistruesit, vendim i cili, më pas, është revokuar për shkak se u provua që vonesa në shlyerjen e detyrimit nuk ka qenë për faj të tij, por për arsye të mosçeljes në kohë të fondeve.

Gjykata Kushtetuese çmon se, nisur nga koha që kërkon marrja e hapave të nevojshëm proceduralë për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë nga organet përkatëse, si dhe procedurat që duhet të ndiqen për çeljen e fondeve buxhetorë, afati brenda të cilit u ekzekutua vendimi gjyqësor nuk mund të konsiderohet i paarsyeshëm. Kështu, konstatohet se pasi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat mori formë të prerë dhe u lëshua urdhri i ekzekutimit nga kjo gjykatë nr.120, datë 13.07.2007, kërkuesi, me datë 20.07.2007, i është drejtuar zyrës së përmbarimit Berat, e cila për shkak të mungesës së kompetencës, ia ka transferuar çështjen zyrës së përmbarimit Tiranë. Kjo e fundit ka ndërmarrë të gjitha hapat për të ekzekutuar vendimin ndaj kryeregjistruesit, i cili nga ana e tij i ka dërguar Ministrisë së Drejtësisë, institucion nga i cili varet ZRPP, 3 shkresa që prej korrikut 2007 e deri në qershor 2008, duke i kërkuar çeljen e fondeve me qëllim ekzekutimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë, midis të tjerave dhe vendimin me kreditor kërkuesin dhe debitor kryeregjistruesin. Shkak për vonesën e pretenduar nga kërkuesi ka qenë koha e nevojshme për parashikimin dhe çeljen e fondeve nga Buxheti i Shtetit.

Pra, gjatë gjithë procesit për ekzekutimin e vendimit, Gjykata Kushtetuese nuk vëren asnjë veprim të tillë që të ketë pasur si qëllim shmangien e debitorit, nga detyrimi për të zbatuar vendimin gjyqësor, gjë që është një tregues i qartë për mosmungesë të vullnetit në shlyerjen e dëmit të shkaktuar kreditorit. Prandaj, Gjykata Kushtetuese e gjen të pabazuar pretendimin për tejzgjatje të afatit të arsyeshëm në ekzekutimin e vendimit të formës së prerë.

Gjithashtu, duke qenë se Gjykata Kushtetuese nuk konstaton vonesë apo mungesë vullneti për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga ana e debitorit, si dhe duke vlerësuar se afati brenda të cilit u ekzekutua vendimi gjyqësor i formës së prerë nuk është i paarsyeshëm, çmon se edhe pretendimi i kërkuesit për dëmshpërblim financiar nuk mund të merret në shqyrtim. Dëmshpërblimi financiar është i lidhur ngushtë me evidentimin e shkeljes konkrete që pretendon kërkuesi. Moskonstatimi i shkeljes, i cili është kusht kryesor për të njohur të drejtën e kreditorit për dëmshpërblim financiar si rrjedhojë e dëmit të shkaktuar, sjell si pasojë edhe mos marrjen në shqyrtim të kërkesës për dëmshpërblim financiar.

Si përfundim, në vijim të arsyetimit të mësipërm, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata Kushtetuese nuk konstaton cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor të kërkuesit si rrjedhojë e mosekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6/1 të KEDNJ.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f të Kushtetutës dhe neneve 23 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Vladimir Kristo (kryetar), Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Admir Thanza, Sokol Berberi,

Anëtarë kundër: Sokol Sadushi

VENDIM
Nr.22, datë 22.7.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i " "
Kujtim Puto	Anëtar i " "
Xhezair Zaganjori	Anëtar i " "
Petrit Plloçi	Anëtar i " "
Sokol Sadushi	Anëtar i " "
Sokol Berberi	Anëtar i " "
Admir Thanza	Anëtar i " "
Vitore Tusha	Anëtare e " "

me sekretare Blerina Çinari, në datë 12.02.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.33/18 Akti, që i përket:

KËRKUES: Haxhi Demiri, përfaqësuar nga avokat Harallamb Kule, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR:

SHOQËRIA E NDËRTIMIT "AREELA", përfaqësuar nga avokatët Krenar Loloçi dhe Viktor Konomi me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.1172, datë 16.10.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41/1, 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Vitore Tusha; përfaqësuesin e kërkuesit që u shpreh për pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjektit të interesuar që u shpreh për rrëzimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuesi Haxhi Demiri është bashkëpronar i një sipërfaqeje trualli prej 1215 m^2 të ndodhur në Tiranë. Ai dhe bashkëpronarët e tjerë kanë lidhur kontratën e shkëmbimit nr.2049 Rep. e nr.242 Kol, datë 27.06.2002 me shoqërinë e ndërtimit "AREELA" sh.p.k., për të shkëmbyer truallin me 25% të sipërfaqes ndërtimore që do të ndërtohet mbi këtë truall. Në kontratën e shkëmbimit është parashikuar se, nëse nga ana e palës së paditur nuk do të mund të sigurohet leja e ndërtimit brenda 12 muajve nga data e nënshkrimit të kontratës, secila palë ka të drejtë të rishikojë kushtet e kontratës (pika 4). Sipas pikës 5 të kontratës, pala e paditur detyrohet t'u dorëzojë paditësve sipërfaqen e ndërtimit brenda afatit prej 24 muajsh nga data e zbardhjes së lejes së ndërtimit, por ky afat do të konsiderohej i pezulluar për rastet e forcave madhore dhe gjendjes së jashtëzakonshme, si dhe në rastet e konflikteve gjyqësore për pretendime pronësie nga persona të tretë, ose për çdo lloj konflikti tjetër, objekti i të cilit nuk mund të parashikohej. Në pikën 6 të kontratës është parashikuar detyrimi i paditësve për t'i dorëzuar palës së paditur dokumentet e vërtetimit të pronësisë së truallit, si dhe për ta garantuar atë se trualli është i lirë nga çdo barrë, hipotekë ose pretendim pronësie nga persona të tretë.

Kërkuesi dhe bashkëpronarët e tjerë, duke pretenduar se subjekti i interesuar ka shkelur afatin 12-mujor për marrjen e lejes së ndërtimit dhe për fillimin e ndërtimit të godinës, i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padinë me objekt zgjidhjen e kontratës së shkëmbimit nr.2049 Rep. e nr.242 Kol, datë 27.06.2002.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.3606, datë 7.06.2005 ka vendosur pranimin e padisë së paditësve Haxhi Demiri etj., duke zgjidhur kontratën e shkëmbimit për mosplotësim të kushteve dhe afateve të parashikuara në kontratë.

Mbi ankimin e subjektit të interesuar çështja është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr.547, datë 11.05.2006 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar çështjen mbi rekursin e ushtruar nga subjekti i interesuar dhe, me vendimin nr.1172, datë 16.10.2007, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe atë të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrëzimin e padisë me objekt zgjidhjen e kontratës së shkëmbimit.

Kërkuesi, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ka kundërshtuar si antikushtetues vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë duke pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për shkak se i është mohuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Sipas tij:

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arritur në përfundime të ndryshme nga ato të gjykatave të tjera përsa u përket rrethanave të faktit, duke kapërcyer kompetencat e parashikuara në nenin 472 dhe 485 të Kodit të Procedurës Civile dhe duke dalë jashtë juridiksionit rishikues, parashikuar nga neni 141 i Kushtetutës.

- Vendimi i Gjykatës së Lartë bie ndesh me praktikën gjyqësore dhe me vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilave rekurset e bëra për prishjen e vendimeve, për vlerësim të gabuar të provave, janë jashtë kufijve të shqyrtimit të Gjykatës së Lartë.

Subjekti i interesuar, Shoqëria e ndërtimit "AREELA", ka parashtruar si vijon:

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka respektuar të gjitha standardet e procesit të rregullt ligjor. Gjykata e Lartë ka ushtruar kompetencën e saj për shqyrtimin e rekursit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta që ka të bëjë me mosrespektimin ose interpretimin e gabuar të ligjit.

- Interpretimi i kontratës së lidhur midis palëve është interpretim ligjor, pasi kontrata ka forcën e ligjit. Brenda kufijve ligjorë të shqyrtimit të çështjes, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë mund të vendosë ndryshe nga gjykatat më të ulëta.

II

Lidhur me pretendimin për cenimin e standardit kushtetues "për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj".

Në kërkesën e paraqitur përpara Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), kërkuesi i referohet rregullimit kushtetues të parashikuar në nenet 42 dhe 131, shkronja "f" të Kushtetutës, që lidhet me respektimin e standardit "për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj", si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Kërkuesi pretendon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1172, datë 16.10.2007 ka tejkaluar kompetencat e parashikuara nga ligji procedural civil, pasi, nëpërmjet rivlerësimit të provave të marra gjatë gjykimit në shkallën e parë dhe në gjykatën e apelit, ka ndryshuar rrethanat e çështjes dhe ka marrë një vendim në kundërshtim edhe me praktikën gjyqësore dhe me vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilave rekurset e ushtruara ndaj vendimeve për vlerësimin e gabuar të provave janë jashtë kufijve të shqyrtimit të Gjykatës së Lartë.

Gjykata vlerëson se kontrolli kushtetues që ushtron Gjykata Kushtetuese ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit e të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave të lartpërmendura (Shih vendimin nr.31, datë 01.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

Në praktikën e saj Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut është dhe shqyrtimi i çështjes nga një "gjykatë e caktuar me ligj". Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (Shih vendimet nr.31, datë 1.12.2005 dhe nr.7, datë 9.3.2009 të Gjykarës Kushtetuese.

Funksioni rishikues i Gjykatës së Lartë, i sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile, përfshin shqyrtimin e rekurseve që lidhen me pretendimet për shkelje të ligjit material dhe të ligjit procedural (Shih vendimin nr.25, datë 30.07.2003 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata edhe më parë është shprehur, se kompetenca për shqyrtimin e çështjeve nga Gjykata e Lartë nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale, të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Kufijtë brenda të cilëve Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë shqyrton çështjet mbi rekursin e ushtruar, janë të parashikuar në nenet 472 dhe 485 të Kodit të Procedurës Civile. Gjykimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, lidhet me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të marra nga gjykatat më të ulëta (Shih vendimin nr.31, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese), ndërsa "… nxjerrja e konkluzionit mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave, nga vlerësimi i dy gjykatave të shkallëve më të ulëta, nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë" (Shih vendimin nr.17, datë 30.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese). Kompetenca e Kolegjit Civil, apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që të ndryshojnë njëkohësisht vendimet e të dy gjykatave, si të gjykatës së apelit, ashtu dhe të gjykatës së shkallës së parë, bazohet në nenin 485 të Kodit të Procedurës Civile (Shih vendimin nr.31, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

Lidhur me çështjen në shqyrtim Gjykata konstaton, se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duke arsyetuar rreth qëndrimit të gabuar të mbajtur nga gjykata e rrethit gjyqësor dhe e apelit, ka pranuar se këto gjykata kanë vepruar në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 4 të kontratës së shkëmbimit

dhe nenit 702 të Kodit Civil. Nisur nga përmbajtja e këtyre dispozitave, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se "… shkelja e afatit për sigurimin e lejes së ndërtimit nga pala e paditur nuk përbën kusht e nuk passjell zgjidhjen e kontratës". Sipas Gjykatës së Lartë, "si gjykata e shkallës së parë, ashtu dhe ajo e apelit kanë gabuar duke e trajtuar dhe konsideruar shkeljen e afatit për sigurimin e lejes së ndërtimit nga pala e paditur si kusht për zgjidhjen e kontratës së shkëmbimit".

Nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe nga dokumentacioni i kësaj çështje, Gjykata Kushtetuese konstaton, se procesi në Gjykatën e Lartë është bazuar tërësisht mbi fakte, të pranuara nga gjykatat më të ulëta gjatë gjykimit të çështjes. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arritur në përfundimin se vendimet e gjykatave të zakonshme janë marrë mbi bazën e interpretimit të gabuar, si të përmbajtjes së kontratës së shkëmbimit të lidhur midis palëve kontraktuese, ashtu dhe të dispozitave të Kodit Civil ku ato janë bazuar dhe, për këto arsye ligjore, ka vendosur ndryshimin e të dy vendimeve dhe rrëzimin e padisë.

Gjykata Kushtetuese vlerëson, se interpretimi i një dispozite të kontratës apo i përmbajtjes në tërësi të saj, ashtu si dhe interpretimi i ligjit, është brenda kufijve ligjorë të shqyrtimit të çështjeve nga Gjykata e Lartë dhe në përputhje me të drejtën e saj për të vlerësuar respektimin e ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata Kushtetuese nuk vlerëson nëse interpretimi i kontratës apo i dispozitave të Kodit Civil nga Gjykata e Lartë është i drejtë nga pikëpamja ligjore, por nëse interpretimi sjell si pasojë cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese konkludon se Gjykata e Lartë, duke kontrolluar çështjen nga pikëpamja ligjore është në funksionin e saj si gjykatë e ligjit.

Sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesit nuk i është cenuar e drejta e gjykimit nga një "gjykatë e caktuar me ligj", pasi procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në përputhje me kompetencat e caktuara nga ligji. Në këto kushte, Gjykata nuk konstaton cenimin e ndonjë aspekti të së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ dhe, për rrjedhojë verëson se kërkesa duhet rrëzuar si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Kujtim Puto, Vladimir Kristo (kryetar), Sokol Sadushi, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Vitore Tusha, Admir Thanza, Sokol Berberi

VENDIM
Nr.23, datë 23.7.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar	i "	"
Kujtim Puto	Anëtar	i "	"
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i "	"
Petrit Plloçi	Anëtar	i "	"
Vitore Tusha	Anëtare	e "	"
Sokol Sadushi	Anëtar	i "	"
Admir Thanza	Anëtar	i "	"
Sokol Berberi	Anëtar	i "	"

me sekretare Blerina Çinari, në datë 26.03.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.2 Akti, që i përket:

KËRKUES: Arben Grori, përfaqësuar nga avokat Agron Lamaj, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë. Ministria e Drejtësisë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.1200, datë 29.12.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; vendimit nr.469, datë 25.06.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr.389, datë 23.06.2006 të Gjykatës së Lartë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi, përfaqësuesin e kërkuesit që u shpreh për pranimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.1200, datë 29.12.2003 ka deklaruar fajtor kërkuesin për veprat penale të "shitjes dhe trafikimit të lëndëve narkotike", sipas nenit 283/2 të Kodit Penal (KP), dhe të "krijimit të organizatës kriminale", sipas nenit 333 të KP. Kjo gjykatë e ka deklaruar kërkuesin të pafajshëm për veprat penale të "organizimit dhe drejtimit të organizatave kriminale", sipas nenit 284/a/1 të KP dhe "kryerjes së krimeve nga organizata kriminale", sipas nenit 334/2 të KP. Në zbatim të nenit 55 të KP kërkuesi është dënuar përfundimisht me 19 vjet burgim. Kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë kanë apeluar si kërkuesi ashtu dhe prokurori.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.469, datë 25.06.2004, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, por duke bërë një ndryshim përsa i përket deklarimit fajtor të kërkuesit për veprën penale të "shitjes së lëndëve narkotike", sipas nenit 283/2 të KP, të ndryshuar, dhe e ka dënuar me 17 vjet burgim. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë kërkuesi ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Gjykata e Lartë, me vendimin nr.389, datë 23.06.2006, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për veprën penale të "prodhimit dhe shitjes së narkotikëve", kryer në bashkëpunim, pushimin e gjykimit të çështjes për veprën penale të krijimit të organizatës kriminale dhe përfundimisht, e ka dënuar kërkuesin me 15 vjet burgim.

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin e vendimit nr.389, datë 23.06.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Gjatë seancës gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese, kërkuesi ndryshoi objektin e padisë dhe përveç shfuqizimit të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, kërkoi dhe shfuqizimin e vendimeve të dy shkallëve të tjera.

Kërkuesi ka pretenduar se vendimet e përmendura më sipër, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë janë rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor në këto drejtime:

- Provat janë marrë në mënyrë të paligjshme. Gjykatat nuk kanë respektuar në proces të drejtën ndërkombëtare, të detyrueshme për zbatim; Konventa e Këshillit të Europës për Transferimin e Procedimeve dhe Konventa për Ndihmë të Ndërsjellë në Fushën Penale janë zbatuar në mënyrë të gabuar.

- Është cenuar parimi i barazisë së armëve. Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e kërkuesit për proces të rregullt duke mos respektuar dispozitat e KPP lidhur me provat. Kjo Gjykatë nuk ka thirrur, verifikuar dhe pyetur në cilësinë e dëshmitarit apo të pandehurit, në një procedim të lidhur me çështjen, asnjë prej tyre. Në këtë aspekt, janë shkelur nenet 31/d i Kushtetutës dhe 6/3–d i KEDNJ lidhur me të drejtën e pyetjes së dëshmitarëve, ekspertëve dhe të pandehurve.

- Është shkelur e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

- Është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e krijuar me ligj.

- Është cenuar standardi i përcaktuar në nenin 142/1 të Kushtetutës dhe i zbërthyer në interpretimet e Gjykatës Kushtetuese lidhur me detyrimin për arsyetimin e vendimit gjyqësor, pasi mungoi disponimi i detyrueshëm i gjykatës për të përmbledhur rrethanat e faktit lidhur me krimin për të cilin akuzohej, për të deklaruar provat mbi të cilat u bazua vendimi dhe arsyet përse i ka konsideruar të papranueshme provat e kundërta.

- Vendimi i Gjykatës së Lartë cenon standardet e vendosura nga Gjykata e Strasburgut lidhur me informimin e plotë e të qartë për akuzat e ngritura, si dhe për kualifikimin juridik të veprës, si kusht thelbësor për besueshmërinë e procesit.

- Është shkelur parimi i prezumimit të pafajësisë.

II

a) Lidhur me pretendimin se provat në proces janë marrë në mënyrë të paligjshme dhe jo në përputhje me Konventën Ndërkombëtare për Ndihmën Juridike në Fushën Penale e atë për Transferimin e Procedimeve

1. Kërkuesi pretendon se e drejta e tij për një proces të rregullt ligjor është shkelur për arsye se, mënyra e marrjes së provave në ngarkim të kërkuesit në procesin penal kundër tij për veprat penale të trafikimit ndërkombëtar të lëndëve narkotike dhe të krijimit të organizatës kriminale, është bërë në mënyrë të kundërligjshme. Në mënyrë të përmbledhur kërkuesi pretendon, se transferimi i procedimit, akteve dhe provave nga autoritetet gjyqësore italiane tek ato shqiptare është bërë në mënyrë të paligjshme. Konventa Europiane për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale nuk mund të zbatohet pasi Shqipëria ka bërë një rezervë duke deklaruar, se do të refuzojë dhënien e ndihmës juridike për ato vepra penale, të cilat janë në proces hetimi.

2. Gjykata është shprehur se barazia e armëve dhe marrja e provave në mënyrë të ligjshme, përbëjnë aspekte të rëndësishme të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe nga neni 6 i KEDNJ-së (Shih vendimet e GJK nr.19, datë 18.09.2008; nr.95, datë 27.07.2001; nr.7,datë 27.04.2005). Parimi bazë kushtetues që lidh provat me procesin e rregullt është i sanksionuar në nenin 32/2 të Kushtetutës sipas të cilit, askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Gjithashtu, Gjykata është shprehur se interpretimi dhe zbatimi i ligjit procedural është në kompetencë të gjykatave të sistemit gjyqësor. Problemet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit mund të merren në konsideratë nga kjo Gjykatë vetëm nëse, përmes këtij procesi, cenohen të drejtat kushtetuese për një

proces të rregullt ligjor (Shih vendimin e GJK nr.20, datë 29.09.2008).

3. Në këtë kuptim, meqenëse një nga pretendimet e kërkuesit ka të bëjë me mënyrën e marrjes së provave dhe atë të transferimit të tyre nga autoritetet italiane tek ato shqiptare, Gjykata do të vlerësojë fillimisht, nëse veprimet e autoriteteve gjyqësore shqiptare kanë qenë në përputhje me të drejtën e zbatueshme. Neni 10/1 i Kodit të Procedurës Penale (KPP) parashikon se "Marrëdhëniet me autoritetet e huaja në fushën penale rregullohen nga marrëveshjet ndërkombëtare të pranuara nga Shqipëria, nga parimet dhe normat përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare dhe dispozitat e këtij Kodi". Në bazë të neneve 116 dhe 122 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara janë pjesë e sistemit juridik shqiptar dhe ato kanë epërsi mbi ligjet e brendshme në kundërshtim me to. Gjithashtu, këto dispozita ndërkombëtare zbatohen drejtpërdrejt, me përjashtim të rastit kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe për zbatimin e tyre kërkohet nxjerrja e një ligji.

4. Gjykata vëren se aktet ligjore të detyrueshme për zbatim dhe që rregullojnë procedurat në rrethana si ato të çështjes, objekt shqyrtimi janë dy. Së pari, Konventa Europiane për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale dhe së dyti, dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale mbi letërporosinë. Gjykata konstaton, se Konventa Europiane për Transferimin e Procedimeve nuk është ligj i aplikueshëm në rastin në fjalë, për arsye se Italia nuk është shtet palë në këtë Konventë dhe, në bazë të parimit të reciprocitetit, ndonëse Shqipëria e ka ratifikuar këtë Konventë, ajo (Konventa) nuk lind detyrime ndërkombëtare ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë. Gjykata vëren, duke iu referuar korrespondencës ndërmjet dy shteteve (shih më poshtë), se baza ligjore së cilës palët i janë referuar në çështjen objekt shqyrtimi është Konventa Europiane për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale. Fakti që gjykatat e zakonshme i janë referuar në vendim edhe Konventës së Këshillit të Europës mbi Transferimin e Procedimeve, ndonëse është një referencë e gabuar në ligjin e zbatueshëm ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë, nuk cenon thelbin e çështjes, i cili ka të bëjë me mënyrën se si janë dërguar dhe marrë letërporositë nga autoritetet gjyqësore përkatëse.

5. Gjykata vëren, se Konventa Europiane për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale dhe Protokolli Shtesë janë ratifikuar si nga Shqipëria ashtu edhe nga Italia. Kuvendi e ka ratifikuar Konventën me ligjin nr.8498, datë 10.6.1999. Konventa ka hyrë në fuqi në datën 3.07.2000 për Shqipërinë, kurse për Italinë në datën 16.06.1962. Ndihma e ndërsjellë juridike në fushën penale është një nga format më të rëndësishme të bashkëpunimit me autoritetet e huaja. Ndihma që jepet me letërporosi konsiston në a) marrjen e provave, e cila konsiston në dëgjimin e dëshmitarëve, ekspertëve apo të pandehurit, si dhe në marrjen e provave shkresore apo dokumenteve që lidhen me një çështje penale në shtetin e huaj; b) dorëzimin e akteve, të cilat mund të jenë akte hetimore, prova materiale, dokumente, fashikuj, procesverbale apo vendime gjyqësore; c) njoftimet dhe komunikimet me letërporosi, që mund të jenë komunikim i një vendimi gjyqësor penal, njoftimi për t'u paraqitur si dëshmitar etj., si dhe d) dërgimi i personave autoriteteve të shtetit të huaj si dëshmitarët, ekspertët apo personat e pandehur.

6. Kërkuesi pretendon se Konventa për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale nuk është e zbatueshme ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë. Gjykata Kushtetuese vëren se rezerva që Shqipëria i ka bërë kësaj Konvente parashikon: "…Republika e Shqipërisë do të refuzojë dhënien e ndihmës juridike në fushën penale… b) për ato vepra penale të cilat janë në proces hetimi në territorin e Republikës së Shqipërisë apo në një territor tjetër". Bazuar në të drejtën ndërkombëtare të traktateve, nëse një shtet i bën rezervë një traktati ndërkombëtar atëherë, në bazë të parimit të reciprocitetit, të gjitha shtetet palë mund të zgjedhin të mos e respektojnë këtë detyrim specifik të përmbajtur në rezervë, që do të thotë, se teksti i traktatit modifikohet sipas rezervës së parashikimeve të nenit 21 të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve. Gjykata vëren se, siç shihet edhe nga teksti i rezervës, parashikimi lidhet me refuzimin e ndihmës nga Shqipëria. Në rastin konkret, është Shqipëria shteti që ka kërkuar ndihmë juridike dhe jo e anasjellta. Nga ky formulim kuptohet qartë se autoritetet shqiptare nuk do ta zbatonin Konventën, nëse çështja për të cilën kërkohet ndihma e ndërsjellë juridike është në proces hetimi në Shqipëri dhe, për arsye të hetimeve, Shqipëria vendos të mos i transferojë/kalojë provat e mbledhura prej saj në këtë fazë. Italia, referuar korrespondencës zyrtare, nuk i referohet në asnjë vend faktit që çështja është në

hetim në Itali, përkundrazi, jep pëlqimin e saj për dhënien e ndihmës juridike për çështjen në ngarkim të kërkuesit. Për rrjedhojë, Konventa, në çështjen objekt shqyrtimi, është ligj i zbatueshëm ndërmjet palëve për ndihmën e ndërsjellë juridike.

7. Neni 1 i Konventës sqaron qëllimin dhe objektin e saj. Kështu, palët angazhohen të japin në mënyrë të ndërsjellë, sipas dispozitave të kësaj Konvente, një bashkëpunim sa më të gjerë gjyqësor në çdo rast procedimi që lidhet me krimet, dënimi i të cilave është, që nga momenti në të cilin është kërkuar ndihma, kompetencë e autoriteteve gjyqësore të palës kërkuese. Lidhur me letërporositë, neni 3 (1) i Konventës shprehet se pala së cilës i drejtohet kërkesa do të ekzekutojë, sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni i vendit të saj, letërporositë që lidhen me një procedim penal, që i drejtohen asaj nga autoritetet gjyqësore të palës kërkuese dhe që kanë për objekt plotësimin e akteve hetimore ose kalimin e provave materiale që lidhen me veprën penale përkatëse, të fashikujve ose të dokumenteve. Neni 15 (1) parashikon se letërporositë, për të cilat nenet 3, 4 dhe 5, si edhe kërkesat e parashikuara në nenin 11, do të drejtohen nga Ministria e Drejtësisë e palës kërkuese tek Ministria e Drejtësisë e palës së cilës i është drejtuar kërkesa dhe do të kthehen nëpërmjet të njëjtës rrugë. Në rast urgjence, këto letërporosi mund të dërgohen edhe drejtpërsëdrejti nga autoritetet gjyqësore të palës kërkuese tek autoritetet gjyqësore të palës së cilës i drejtohet kërkesa. Lidhur me nenin 15 të Konventës, Shqipëria ka deklaruar (neni 2 i ligjit nr.8498, datë 10.06.1999) se: "… pala shqiptare deklaron se në zbatim të nenit 15, pika 6 duhet që një kopje e të gjitha kërkesave për ndihmë juridike, të komunikuara drejtpërdrejt ndërmjet autoriteteve gjyqësore, si dhe të akteve shoqëruese t'i dërgohen, në të njëjtën kohë, edhe Ministrisë së Drejtësisë".

8. Përmbajtja e letërporosive ndërkombëtare rregullohet edhe nga Kodi i Procedurës Penale (KPP). Neni 509 përfshin kriteret për dërgimin e letërporosive për jashtë shtetit. Sipas këtij neni, letërporositë e gjykatave dhe prokurorive, të drejtuara autoriteteve të huaja për njoftimet dhe marrjen e provave, i dërgohen Ministrisë së Drejtësisë, e cila merr masa për t'i nisur ato. Neni 511 shprehet për vlerën e akteve të marra me letërporosi. Kur shteti i huaj ka vënë kushte për përdorshmërinë e akteve të kërkuara, autoriteti procedues shqiptar është i detyruar t'i respektojë, në qoftë se ato nuk vijnë në kundërshtim me ndalimet e caktuara nga ligji.

9. Në çështjen në shqyrtim, nga dosja gjyqësore rezulton:

- Më datë 2.05.2001 Prokuroria e Përgjithshme e Shqipërisë u ka kërkuar autoriteteve gjyqësore italiane, me letërporosinë nr.823/2, dërgimin e të gjitha akteve dhe provave në ngarkim të kërkuesit. Një kopje e kësaj letërporosie i është dërguar Ministrisë së Drejtësisë dhe një kopje drejtpërdrejt autoriteteve gjyqësore të Milanos.

- Më datë 8.05.2001, me shkresën nr.2498/2 Prot., Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë i ka kërkuar Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Italisë ndihmë juridike lidhur me çështjen (kjo shkresë përmendet në letrën që Ministria e Drejtësisë i dërgon më datë 28.01.2003 Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë). Të njëjtën referencë te shkresa e datës 08.05.2001 e konfirmon edhe shkresa e ardhur nga Ministria e Drejtësisë së Italisë datë 23.04.2002).

- Me 25.06.2001, me letërporosinë RP/1449/01/VD/VA drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Shqipërisë, Ministria Italiane e Drejtësisë shkruan "… transferohen aktet e ardhura nga autoritetet kompetente gjyqësore italiane në vijim të kërkesës për ndihmë të ndërsjellë juridike e dërguar drejtpërdrejt nga Prokuroria e Përgjithshme, datë 2.5.2001 nr. Prot. 823/2".

- Me shkresën nr.3744/1 Prot. datë 23.07.2001, Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë i ka përcjellë këto akte dhe prova në Prokurorinë e Përgjithshme.

- Më datë 29.06.2001, me shkresën nr.823/8, datë 29.06.2001 Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar një tjetër letërporosi në Ministrinë e Drejtësisë së Shqipërisë, e cila ua ka përcjellë autoriteteve gjyqësore italiane, në zbatim të nenit 15 të Konventës Europiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Fushën Penale, ku kërkohen të gjitha provat dhe aktet procedurale penale lidhur me procesin penal në ngarkim të kërkuesit.

- Më 23.04.2002, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Italisë, me shkresën nr.RIF.n[RP/1652/01/VD/VA-Albania drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Shqipërisë ka dërguar aktet e kërkuara në bazë të shkresës së datës 8.05.2001, nr. Prot 2498/2.

- Në datat 23.04.2003 dhe 16.06.2003 Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë për dërgimin e letërporosive lidhur me kërkesën e saj drejtuar autoriteteve italiane për të marrë informacion për disa elemente të procesit ndaj kërkuesit, përfshi statusin e procedimit dhe pyetjen e disa shtetesave shqiptarë, gjykuar dhe arrestuar pranë autoriteteve gjyqësore të huaja.

- Më datë 16.06.2003, Ministria e Drejtësisë e Shqipërisë i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë së Italisë, duke i përcjellë korrespondencën me Gjykatën e Shkallës së Parë të datës 16.06.2003, nr. Akti 109.

- Më datë 3.10.2003, me letërporosinë me nr.RP/1449/2001/VD-Albania, Ministria e Drejtësisë Italiane shprehet se autoritetet gjyqësore italiane kanë transferuar procedimin penal pranë autoriteteve gjyqësore shqiptare si dhe bëjnë të ditur hapat për realizimin e kërkesës së Gjykatës së Shkallës së Parë për pyetjen e dëshmitarëve.

- Më datë 3.10.2003, Ministria e Drejtësisë e Italisë i dërgon Ministrisë së Drejtësisë së Shqipërisë një letërporosi me nr.RP/1499/2001/VD-Albania, ku referencë i bëhet veprimeve të autoriteteve italiane lidhur me kërkesën nga autoritetet shqiptare për procedimin e marrjes në pyetje të personave, emrat e të cilëve janë renditur si të burgosur dhe/ose me banim jashtë zonës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Milanos.

10. Nga shqyrtimi i materialeve në dosje, Gjykata vëren, se të gjitha këto letërporosi janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Aktet e dërguara nga autoritetet italiane janë kopje të njësuara me origjinalin, sikurse parashikohet në nenin 3/3 të Konventës së Këshillit të Europës për Ndihmë të Ndërsjellë në Fushën Penale. Nga korrespondenca e sipërcituar dhe duke iu referuar dosjes gjyqësore, konstatohet se të gjitha letërporositë janë dërguar dhe marrë në përputhje me dispozitat e Konventës për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike dhe neneve përkatëse të KPP.

11. Aktet e siguruara me letërporosi kanë vlerën e provës në qoftë se janë marrë në përputhje me normat procedurale shqiptare. Në doktrinën e së drejtës penale, lidhur me marrjen e provave me letërporosi, çështja e ligjit të zbatueshëm është shumë e rëndësishme. Pyetja kryesore që lidhet me këtë çështje është nëse prova merret sipas ligjit të shtetit kërkues, apo në përputhje me ligjin e shtetit të kërkuar. Një shtet mund të kërkojë që disa formalitete të zbatohen në mënyrë që ai shtet ta pranojë provën e mbledhur gjatë procesit.

12. Siç u përmend dhe më sipër, parimi bazë kushtetues që lidh provat me procesin e rregullt është i sanksionuar në nenin 32/2 të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Provat trajtohen në Titullin IV të KPP. Në gjykim provat merren me kërkesën e palëve. Prova nuk mund të përdoret kur është marrë në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi (neni 152 i KPP). Neni 193 i KPP, pjesë e seksionit VIII mbi dokumentet si lloje provash në një procedim penal parashikon, që si të tilla, mund të merren edhe procesverbalet e procedimeve të tjera. Kështu, neni 193/1 parashikon se lejohet marrja e procesverbaleve të procedimeve të tjera penale që kanë të bëjnë me sigurimin e provës ose me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

13. Nga shqyrtimi i të gjitha materialeve të dosjes gjyqësore Gjykata vëren, se mënyra e marrjes së provave në procesin gjyqësor në ngarkim të kërkuesit është bërë në përputhje me dispozitat e sipërpërmendura të Konventës për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale dhe me nenet 193, 505 e në vijim të KPP. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit se provat në proces janë marrë në mënyrë të paligjshme dhe jo në përputhje me konventat ndërkombëtare përkatëse, është i pabazuar.

b) Lidhur me pretendimin se është cenuar parimi i barazisë së armëve

14. Kërkuesi pretendon se të gjitha provat e fajësisë janë mbledhur dhe vlerësuar sipas ligjit penal italian dhe i gjykuari apo avokati i tij nuk janë prezantuar apo ballafaquar me asnjë provë, megjithëse e kanë kërkuar këtë të drejtë; procesi nuk ka ofruar mundësi të barabarta për të dyja palët; janë shkelur neni 31/d i Kushtetutës dhe neni 6/3 – d i KEDNJ lidhur me të drejtën e pyetjes së dëshmitarëve, ekspertëve dhe të pandehurve.

15. Lidhur me parimin e barazisë së armëve, Gjykata ka vlerësuar se veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe lidhur ngushtë me këto, mbrojtja e të pandehurit, e garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ, përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor. Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata, me objektivitet e paanësi (Shih vendimet nr.19, datë 12.06.2003 dhe nr.19, datë 18.09.2008 të Gjykatës Kushtetuese). Lidhur me parimin e barazisë së armëve Gjykata mban qëndrimin se provat paraqiten dhe marrin vlerën e tyre në debatin gjyqësor, ku secila palë ka mundësi për të paraqitur argumentet e veta në një pozitë jo më pak të favorshme se pala tjetër (Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 18.09.2008 dhe nr.7, datë 27.04.2005).

16. Edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) thekson se, sipas parimit të barazisë së armëve, secilës palë duhet t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të prezantuar çështjen e vet, në kushte të cilat nuk e vendosin në një pozitë më pak të favorshme përkundrejt kundërshtarit (Shih vendimin e GJEDNJ Bulut v. Austrisë të 22.02.1996, pp. 380-81, para. 47; Vendimin Foucher kundër Francës, 18/03/1997, Aplikimi 22209/93, para.34). Barazia e armëve në një proces penal do të thotë që si prokuroria, ashtu edhe mbrojtja, të kenë mundësi të njihen dhe të komentojnë/debatojnë mbi parashtrimet e vendosura në dosje dhe provat e mbledhura nga pala tjetër.

17. Nga analiza e dosjes gjyqësore, përfshi procesverbalet e seancave gjyqësore, vërehet se në të gjitha shkallët e gjykimit të kërkuesit, mbrojtësit të tij i janë dhënë mundësi dhe i është lënë kohë e mjaftueshme në dispozicion për të dëgjuar dhe debatuar të gjithë argumentet ligjore të ngritura nga akuza dhe mbrojtja. Në shkallë të parë, gjykimi ka vazhduar për më shumë se dy vjet, kohë kjo e mjaftueshme, siç del nga procesverbalet e seancave gjyqësore, për t'u përgatitur dhe për të paraqitur në kohë argumentet në favor të kërkuesit.

18. Gjykata vëren, se gjykatat e kanë sqaruar kërkuesin p.sh. për të drejtën e deklarimeve në çdo fazë të hetimit, duke i dhënë mundësi për të shprehur pikëpamjet e veta; është krijuar mundësia e pyetjes së ekspertëve (përkthyesve) kërkuar nga mbrojtja; provat e ardhura nga Italia janë debatuar në gjykatë. Kështu, gjykata e shkallës së parë ka vendosur që akuza të paraqesë të gjitha provat, mbrojtja të njihet me to dhe më pas të bëjë kundërshtimet. Provat e paraqitura nga prokuroria i janë nënshtruar debatit gjyqësor. Edhe në Gjykatën e Apelit provat janë debatuar nga prokurori dhe mbrojtësi në seancë, duke pasur secila palë një mundësi të përshtatshme dhe reale në përputhje me parimin e kontradiktoritetit. Në rekursin në Gjykatën e Lartë palët kanë shprehur parashtrimet e tyre për të gjitha çështjet e ligjit që ato kanë konsideruar të nevojshme, dhe këtë e kanë bërë dhe me gojë në seancë. Të gjitha thëniet e kërkuesit dhe mbrojtësve të tij janë fiksuar në procesverbalet e seancave gjyqësore dhe, së bashku me parashtrimet me shkrim, janë pjesë e dosjes gjyqësore.

19. Bazuar në sa më lart, Gjykata çmon se kërkuesi dhe mbrojtësi i tij kanë pasur mundësi që gjatë gjithë procesit të njihen me të gjitha materialet e dosjes, të paraqesin kundërshtimet e tyre për to, dhe të dëgjohen. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve, është i pabazuar.

c) Lidhur me pretendimin se është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme

20. Kërkuesi pretendon se në shkallë të parë gjykimi është filluar nga një trupë gjyqësore në përbërje të së cilës ishin tre gjyqtarë civilë dhe zëvendësimi i një gjyqtari është bërë në kundërshtim me rregullat procedurale; se caktimi i një gjyqtari ushtarak është bërë në kundërshtim me rregullat procedurale; e njëjta gjyqtare ka marrë pjesë në të dy gjykimet gjyqësore, në Gjykatën e Apelit (12.05.2001) dhe në Gjykatën e Lartë (30.05.2005); relatori i çështjes në Gjykatë të Lartë ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi pasi ka pasur shkaqe subjektive, megjithatë kjo dorëheqje nuk është pranuar.

21. Gjykata fillimisht sqaron standardin kushtetues që lidhet me termin "gjykatë e paanshme". Neni 42, paragrafi 2 i Kushtetutës parashikon se: "Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë … ka të drejtën e një gjykimi të drejtë … nga një

gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj". Gjykata ka sqaruar, në shumë vendime të saj, nocionin e "gjykatës së paanshme". E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.4, datë. 25.02.2009). Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata duhet të marrë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Në shtetin e së drejtës, kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që duhet të krijojnë në çdo rast në shoqërinë demokratike jo vetëm palët në gjykim, por çdo qytetar (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.12, datë 13.04.2007). Paragjykimi eventual për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet edhe në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.4, datë 25.02.2009).

22. Lidhur me pretendimin e kërkuesit për shkelje të parimit të gjykatës së paanshme, përsa i përket përbërjes së trupit gjykues në shkallë të parë Gjykata vëren se në rastin në shqyrtim, në seancën e datës 15.07.2003 në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, është bërë ndryshimi i gjyqtarit M.D. me B.K. Sipas të dhënave në dosjen gjyqësore, gjyqtari M.D. është zëvendësuar pasi largohej nga Shqipëria për arsye familjare. Kërkuesi dhe avokati i tij kanë shprehur kundërshtimin e tyre, me argumentin se dosja është voluminoze dhe anëtari i ri nuk është i njohur me dosjen. Më pas, më datën 15.07.2003, avokati dhe kërkuesi kanë hequr dorë nga kërkesa për të kundërshtuar trupin gjykues, për të mos zvarritur gjykimin. Në bazë të nenit 342/4 të KPP, anëtari i trupit gjykues është njohur me përmbajtjen e dosjes dhe ka kërkuar të vazhdojë gjykimi në këtë fazë. Në seancën e datës 10.11.2003, avokatët kërkojnë përsëri përjashtimin e gjyqtarit B.K. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë vendos t'ia kalojë për shqyrtim kërkesën një tjetër trupi gjykues. Kërkesa rrëzohet nga trupi tjetër gjykues me vendimin nr.109/1, datë 18.11.2003, duke u shprehur se gjyqtari M.D. nuk ka hequr dorë nga gjykimi, por është zëvendësuar për shkak të largimit jashtë shtetit për një afat të pacaktuar. Më datën 24.11.2003, me vendimin nr.109/2, gjykata e shkallës së parë, me gjyqtare E.B., vendosi rrëzimin e kërkesës së kërkuesit për përjashtimin e gjyqtarit B.K., pasi e gjeti zëvendësimin e gjyqtarit M.D. në përputhje me nenin 342/2 të KPP. Nenet të cilave u referohet i pandehuri kanë të bëjnë me përjashtimin dhe heqjen dorë dhe nuk kanë lidhje me parashikimin e nenit 342/2. Kërkuesi nuk e ka apeluar këtë vendim, për rrjedhojë ai ka marrë formë të prerë.

23. Më datën 22.11.2004, avokati i kërkuesit e ngre çështjen e gjyqtarit B.K. në Gjykatën e Lartë, duke i shtuar argumentimit të tij një tjetër element, se ai është caktuar në kundërshtim me kompetencën që kanë gjykatat ushtarake, në bazë të nenit 75 të KPC. Sipas tij ky gjyqtar nuk ka kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes, për rrjedhojë, nuk plotëson kushtet dhe, sipas nenit 128/1/a, aktet e bëra prej tij janë absolutisht të pavlefshme.

24. Gjykata vlerëson lidhur me këtë pretendim, se ndonëse mbrojtja ka paraqitur këtë argument të fundit për të kundërshtuar pjesëmarrjen në gjykim të gjyqtarit B.K., kërkuesi nuk i ka shterruar të gjitha mjetet juridike sipas nenit 131/f të Kushtetutës, për shkak se ai nuk e ka kundërshtuar vendimin gjyqësor të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë të datës 24.11.2003, i cili rrëzon kërkesën e tij lidhur me përjashtimin e këtij gjyqtari. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese nuk mund ta marrë në shqyrtim këtë pretendim të kërkuesit.

25. Lidhur me pretendimet e kërkuesit për shkeljen e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme si rezultat i përbërjes së trupit gjykues në Gjykatë të Lartë, Gjykata Kushtetuese vëren se nga dosja gjyqësore rezulton se gjyqtari Y.M. ka paraqitur një kërkesë në datën 6.06.2005, me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga gjykimi i çështjes penale në ngarkim të të pandehurve, duke u shprehur se ka shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes penale në ngarkim të tyre… Më datë 8.06.2005 kryetari i Gjykatës vendosi, ndër të tjera, se: "… kërkesa dhe

shkaku i paraqitur nga gjyqtari nuk gjen mbështetje në nenin 17/c të Kodit të Procedurës Penale… nuk ndodhemi edhe përpara ndonjërit prej shkaqeve të papajtueshmërisë të parashikuara në nenin 17, pika "e" në lidhje me nenet 15 dhe 16 të Kodit të Procedurës Penale. Më datën 10.06.2005, gjyqtari Y. M. shprehet se ai ka kërkuar heqje dorë, pasi ka menduar se ekziston një arsye e fortë për të pasur frikë se i mungon paanshmëria.

26. Më datën 12.12.2005, avokati i kërkuesit depoziton në Gjykatë të Lartë kërkesën, me anë të së cilës kërkon përjashtimin e gjyqtarit Y.M. Më datë 5.04.2006, me vendimin nr.919/233, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, mori në shqyrtim këtë kërkesë dhe vendosi mospranimin e saj si të pambështetur në ligj dhe fakte.

27. Gjykata vlerëson, se vendimi i Kolegjit lidhur me kërkesën e gjyqtarit Y.M., është i drejtë. Pjesëmarrja e gjyqtarit ishte vetëm në fazën e pranimit të kërkesës, fazë gjatë së cilës Kolegji ka vlerësuar nëse në rekurs ishin parashtruar shkaqe ligjore sipas KPP. Gjyqtari në këtë fazë nuk shprehet lidhur me themelin e çështjes dhe të gjitha diskutimet nuk bëhen publike. Në rrethanat në fjalë mungojnë realisht kushtet objektive, të cilat do të përligjnin që gjyqtari të hiqte dorë nga gjykimi i çështjes në themel ndaj kërkuesit, sipas kritereve të nenit 17/c të KPP.

28. Gjykata vëren se nga dosja gjyqësore, rezulton se më datën 2.11.2005, në Gjykatën e Lartë depozitohet kërkesa e kërkuesit dhe mbrojtësit të tij lidhur me përjashtimin e gjyqtarëve K.N., V.B. dhe Sh.B.. Ndër të tjera, në këtë kërkesë argumentohet se gjyqtarja Sh.B, me vendimin nr.66, datë 12.05.2001 të Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar masën e sigurimit të vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë. Neni 15/2 i KPP parashikon: "Nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka vlerësuar masën e sigurimit ose të çdo kërkese të prokurorit të paraqitur gjatë hetimit paraprak në të njëjtin procedim". Ky detyrim parashikohet edhe nga neni 17/1/e i KPP. Gjyqtari, në raste të tilla, ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes. E njëjta gjë vlen edhe për dy gjyqtarët e tjerë që kanë vlerësuar masën e sigurimit të vendosur nga Gjykata Shkallës së Parë në Gjykatën e Lartë. Lidhur me këtë kërkesë, më datë 22.11.2005 gjyqtari K.N. ka deklaruar heqjen dorë nga gjykimi. Kjo dorëheqje është pranuar nga kryetari i Gjykatës së Lartë më 24.11.2005. Për dy gjyqtarët e tjerë është pranuar kërkesa për përjashtimin e tyre. Nga shqyrtimi i dosjes gjyqësore rezulton, se trupi gjykues, i cili ka zhvilluar seancën gjyqësore dhe ka marrë vendimin nuk përbëhet nga gjyqtarët e lartpërmendur. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, për këtë shkak të përbërjes së trupit gjykues, është i pambështetur.

ç) Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një "gjykatë e caktuar me ligj"

29. Gjykata ka theksuar se shqyrtimi i çështjes nga një "gjykatë e caktuar me ligj" është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Termi "gjykatë" karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë asaj prej ligjit (Shih vendimet nr.7, datë 9.03.2009 dhe nr.31, datë 01.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

30. Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit se Gjykata e Shkallës së Parë dhe e Apelit nuk kanë qenë kompetente për shqyrtimin e çështjes, nuk qëndron. Kjo është e qartë nga ligji nr.9110, datë 24.07.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës për Krime të Rënda dhe Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda" që parashikon se këto gjykata e fillojnë veprimtarinë nga data 1.01.2004, pra pasi procesi ndaj kërkuesit kishte filluar.

31. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.215, datë 21.04.2004 në çështjen me objekt: "Zgjidhja e mosmarrëveshjes për kompetencë", parashikuar në nenin 91/1 të KPP shprehet se gjykata kompetente për gjykimin e çështjes është ajo e Apelit Tiranë dhe jo Gjykata e Apelit për Krime të Rënda. Referuar dhe në vendimin nr.1, datë 16.04.2004 të Kolegjeve të Bashkuara, nëse vendimi që ankimohet në gjykatën e apelit është dhënë në shkallë të parë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kompetente për shqyrtimin e çështjes është Gjykata e Apelit Tiranë.

32. Bazuar në sa më sipër Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë kanë qenë gjykatat kompetente për të shqyrtuar çështjen në ngarkim të kërkuesit dhe, për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se nuk është shkelur në këtë rast parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj.

d) Lidhur me pretendimin për mosarsyetimin e vendimit gjyqësor

33. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke argumentuar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka dhënë një vendim të paarsyetuar.

34. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. "Gjyqësori, në kryerjen e funksioneve i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve dhe vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara. Neni 142 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se gjykata e mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor. Vendimet duhet të përmbajnë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë… Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Pra, gjyqtari duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve" (Shih vendimin nr.11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese).

35. Gjykata ka theksuar se vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (Shih vendimet nr.7, datë 9.3.2009 dhe nr.33, datë 8.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

36. Në vlerësimin e Gjykatës nuk rezulton që vendimi i Gjykatës së Lartë të jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë elementet e përmendura më sipër. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ky vendim nuk cenon kërkesat që lidhen me arsyetimin e vendimit gjyqësor dhe pretendimi i kërkuesit në këtë aspekt është i pabazuar.

dh) Lidhur me pretendimin për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë

Kërkuesi pretendon, se gjykatat e zakonshme, në procesin gjyqësor ndaj tij kanë cenuar dhe parimin e prezumimit të pafajësisë.

37. Prezumimi i pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është *in dubio pro reo*, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte që duhet të provohen nga akuza (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 28.04.2004).

38. Bazuar nga sa më lart, Gjykata vlerëson nëse gjatë procesit është shkelur ndonjë nga elementet e mësipërme të prezumimit të pafajësisë. Nga vlerësimi në tërësi i materialeve paraqitur Gjykatës Kushtetuese, nuk rezulton ndonjë e dhënë e cila të tregojë se anëtarët e gjykatave të zakonshme që kanë shqyrtuar çështjen e kanë filluar procesin me paragjykimin se kërkuesi e ka kryer veprën penale. Dosja gjyqësore nuk përmban ndonjë deklarim formal apo arsyetim, i cili të

tregojë se anëtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë, Apelit apo Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë e konsiderojnë kërkuesin fajtor para se të jepet një vendim përfundimtar për fajësinë e tij. Vendimi për masën e sigurisë arrest me burg dhe vendimi lidhur me sigurimin e provës nuk përmbajnë deklarata ose arsyetime, të cilat sugjerojnë se gjykatat e zakonshme e konsiderojnë kërkuesin si fajtor. Gjykatat e zakonshme nuk e kanë kaluar gjatë procesit barrën e provës nga prokurori tek i pandehuri. Bazuar në sa më sipër, Gjykata çmon se nuk është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë ndaj kërkuesit.

39. Në përfundim, në vijim të vlerësimeve të mësipërme, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e të drejtave të tij për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, në gjykimin e shkallës së parë, në atë të apelit dhe në Gjykatën e Lartë, janë të pambështetura.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Vladimir Kristo (kryetar), Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Admir Thanza, Sokol Sadushi

VENDIM
Nr.24, datë 24.7.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar	i "	"
Kujtim Puto	Anëtar	i "	"
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i "	"
Petrit Plloçi	Anëtar	i "	"
Vitore Tusha	Anëtare	e "	"
Sokol Sadushi	Anëtar	i "	"
Sokol Berberi	Anëtar	i "	"
Admir Thanza	Anëtar	i "	"

me sekretare Blerina Çinari, në datën 12.05.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.7 Akti, që i përket:

KËRKUES: Shoqata e shoqërive të hidrokarbureve, përfaqësuar nga avokatët Thimjo Kondi, Viktor Ikonomi dhe Rigels Ikonomi me autorizim të datës 10.02.2009.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari dhe Zamir Stefani me autorizim.

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.01.2009 “Për cilësinë e lëndës djegëse gazoil (diezel), të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto, të nxjerrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe të tregtuar për automjete rrugore e gjeneratorë.”

2. Pezullimi i zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.01.2009, deri sa vendimi përfundimtar i kësaj Gjykate të hyjë në fuqi.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 131/c, 118/1, 118/2 dhe 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 45 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Admir Thanza; përfaqësuesit e Shoqatës së Shoqërive të Hidrokarbureve (kërkuesi), që kërkuan pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjektit të interesuar, që kërkuan rrëzimin e saj dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Me vendimin nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel” (VKM nr.147) të Këshillit të Ministrave përcaktohet, ndërmjet të tjerash, se në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke filluar nga data 1 janar 2009 do të lejohet, për përdorim në automjetet rrugore dhe gjeneratorët, vetëm tregtimi i lëndës djegëse diezel, që në nomenklaturën e mallrave, përshkruhet në kodin 27101941, e cila plotëson kërkesat e standardit shqiptar S SH EN 590 ose të standardeve të tjera, të barasvlefshme me të (Diezel D1). VKM nr.147 përcakton gjithashtu sasinë e lejuar të squfurit në lëndën djegëse për motorët diezel, e cila nga data 1 janar 2009 nuk lejohet të kalojë 350 mg/kg dhe nga data 1 janar 2011 nuk lejohet të kalojë 10 mg/kg.

Më tej, Këshilli i Ministrave nxori vendimin nr.1110, datë 30.07.2008 “Për cilësinë e lëndës djegëse diezel, të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto, vendase”, (VKM nr.1110) me anë të së cilit lejoi një përjashtim nga VKM nr.147, përsa i përket sasisë së squfurit të lejuar në lëndën djegëse Diezel D1 të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto vendase, e cila do të tregtohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. VKM nr.1110 lejonte që lënda djegëse Diezel D1, e prodhuar nga rafinimi i naftës bruto vendase, të tregtohej në kushte më të favorshme se ajo e importuar, për arsye se ky vendim përcaktonte se sasia e lejuar e squfurit në lëndën djegëse Diezel D1 të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto vendase, nga data 1 janar 2010 nuk lejohet të kalojë 350 mg/kg, nga data 1 janar 2011 nuk lejohet të kalojë 150 mg/kg dhe nga data 1 janar 2012 nuk lejohet të kalojë 10 mg/kg.

Autoriteti i Konkurrencës, pas ankimit të paraqitur pranë tij nga Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve, i rekomandoi Këshillit të Ministrave shfuqizimin e VKM nr.1110 pasi, sipas tij, kufizonte konkurrencën mes ndërmarrjeve që veprojnë në treg për shkak të aplikimit të kushteve të pabarabarta të tregtimit ndërmjet ndërmarrjeve, në lidhje me produktin vendas dhe atë të importit.

Pas këtij rekomandimi Këshilli i Ministrave nxorri vendimin nr.52, datë 14.01.2009 “Për cilësinë e lëndës djegëse gazoil (diezel), të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto, të nxjerrë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të tregtuar për automjete rrugore e gjeneratorë”, i cili është objekt i këtij shqyrtimi pranë Gjykatës Kushtetuese.

Me vendimin nr.52, datë 14.01.2009 Këshilli i Ministrave shfuqizoi vendimin e tij nr.1110, datë 30.07.2008, por dispozitat e shfuqizuara të këtij të fundit u inkorporuan në pikat 6 dhe 7 të vendimit nr.52, datë 14.01.2009. Vendimi, objekt shqyrtimi, lejoi një përjashtim tjetër ndaj ndalimit të vendosur nga vendimi nr.147, datë 21.03.2007 duke lejuar tregtimin e lëndës djegëse gazoil (diezel), për automjete rrugore dhe gjeneratorë, që në nomenklaturën e mallrave, përshkruhet në kodin 27101945 dhe plotëson kërkesat e standartit S SH 31:1997 ose të standardeve të tjera, të barasvlefshme me të (Diezel D2), e cila prodhohet në rafineritë e vendit nga rafinimi i naftës bruto,

të nxjerrë nga vendburimet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Kërkuesi i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për të shfuqizuar këtë akt si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe për të pezulluar zbatimin e tij deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, duke argumentuar se akti, objekt i këtij shqyrtimi kushtetues:

- është në kundërshtim me nenin 11 të Kushtetutës, për arsye se vendos një kufizim të lirisë ekonomike që mund të vendoset vetëm me ligj.

- është në kundërshtim me nenin 118, pika 1 dhe 2, të Kushtetutës, për arsye se është i bazuar në ligjin nr.9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i cili nuk përmban asnjë delegim legjislativ në favor të Këshillit të Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore. Kurse, përsa i përket ligjit nr.8897, datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", kërkuesi pretendon se vendimi objekt shqyrtimi nuk ka lidhje me delegimin legjislativ të bërë nga neni 10, pika 5 e këtij ligji;

- është i papajtueshëm me marrëveshjet ndërkombëtare OBT – GATT (Marrëveshje e Përgjithshme për Tregtinë dhe Tarifat e Organizatës Botërore të Tregtisë) dhe MSA (Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit me Bashkimin Europian), pasi lejon favorizimin e një ndërmarrjeje private me pozitë dominuese në treg për produkte që, pavarësisht nga origjina e tyre, kanë të njëjtin përdorim dhe krijojnë të njëjtat probleme për ndotjen e mjedisit;

- duhet pezulluar pasi, nëse ky vendim zbatohet, dëmtohen rëndë interesat e anëtarëve të kërkuesit, si dhe konkurrencën në treg, duke u favorizuar arbitrarisht shoqëria ARMO sh.a.

Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, parashtroi se kërkesa duhet rrëzuar pasi:

- Kërkuesi nuk legjitimohet për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për arsye se nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet lirisë ekonomike të anëtarëve të kërkuesit dhe vendimit të kundërshtuar, sepse antikushtetutshmëria e këtij vendimi, edhe nëse pranohet, nuk ndryshon pozitën e anëtarëve të kërkuesit.

- Nuk është në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese shqyrtimi i pretendimit të kërkuesit se është shkelur ligji nr.9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", pasi ky pretendim i përket vlerësimit të papajtueshmërisë së ligjeve me njëri-tjetrin.

- Referimi i vendimit objekt shqyrtimi te nenet 8 dhe 9 të ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" mund të jetë i gabuar, por ky gabim nuk passjell antikushtetutshmërinë e tij.

- Vendimi, objekt shqyrtimi kushtetues, është nxjerrë në kuadrin e një rezerve ligjore relative që mundëson nxjerrjen e akteve nënligjore për të disiplinuar një çështje, e cila, përveçse nga ligji që cakton linjat dhe parimet themelore, duhet të disiplinohet edhe nga burime të tjera. Rrjedhimisht ky vendim nuk është në kundërshtim me nenin 118/1 të Kushtetutës.

- Vendimi i mësipërm është në përputhje të plotë me nenin 118/2 të Kushtetutës, pasi ligji nr.8897, datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja" autorizon nxjerrjen e aktit nënligjor të llojit vendim nga Këshilli i Ministrave, për përcaktimin e kritereve të cilësisë së lëndëve djegëse.

- Kufizimi i lirisë ekonomike nuk është vendosur nga aktet nënligjore VKM nr.147 apo vendimi objekt shqyrtimi, por nga ligji nr. 8897, datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", në zbatim të të cilit kanë dalë këto vendime.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nuk ka shkelur Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA), pasi neni 42 i kësaj marrëveshjeje parashikon mundësinë e vendosjes së kufizimeve të ngjashme me ato të bëra nga ligji nr. 8897, datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja" dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

II

1. Lidhur me pretendimin e subjektit të interesuar se kërkuesi nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese sipas objektit të kërkesës.

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka interpretuar, në jurisprudencën e saj, kriteret kushtetuese për legjitimimin e organizatave si subjekte që mund ta vënë atë në lëvizje (Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9/2008, 41/2007, 35/2007, 11/2007, 9/2007). Shoqatat ose organizatat e tjera janë përcaktuar në nenin 134, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës, si subjekte që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.35, datë 10.10.2007). Ato kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme, të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak.

Gjykata Kushtetuese ka çmuar, se kuptimi mbi legjitimimin duhet parë edhe në këndvështrimin e dallimit që ekziston ndërmjet pretendimit për cenim të së drejtës për veprimtari të lirë ekonomike (neni 11 i Kushtetutës) dhe pretendimit për antikushtetutshmëri të aktit nënligjor të kundërshtuar, në kuptim të rregullimit kushtetues të parashikuar nga neni 118 i Kushtetutës (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 25.07.2008).

Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve është një subjekt juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.810, datë 28.10.2003. Anëtarët e shoqatës janë shoqëritë e tregtimit me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve në Shqipëri. Në statutin e shoqatës parashikohet, ndër të tjera, se qëllimi kryesor i shoqatës është "… përfaqësimi, dhe mbrojtja e interesave të përbashkët të anëtarëve në kuadrin e zhvillimit të tregut të hidrakarbureve". Kërkuesi është organizatë që mbron interesat ekonomikë të anëtarëve të saj, të cilët janë persona juridikë që ushtrojnë aktivitet ekonomik në tregun e hidrokarbureve. Ai pretendon se vendimi, objekt i këtij gjykimi pranë Gjykatës Kushtetuese, krijon një diskriminim *in favorem*, në favor, të produktit Diezel D1 i prodhuar nga vendburimet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, kundrejt atij të importuar nga anëtarët e kërkuesit. Gjithashtu, kërkuesi pretendon se vendimi objekt shqyrtimi, dëmton interesat ekonomikë të anëtarëve të tij nëpërmjet krijimit të një monopoli të përkohshëm duke lejuar vetëm tregtimin e lëndës djegëse Diezel D2 të prodhuar nga shoqëria ARMO sh.a. Për këto arsye vendimi nr.52, datë 14.01.2009 i Këshillit i Ministrave ndërhyn drejtpërdrejt në fushën e aktivitetit ekonomik të anëtarëve të kërkuesit, duke karakterizuar kështu lidhjen e drejtpërdrejtë me lirinë e veprimtarisë ekonomike të anëtarëve të kësaj shoqate.

2. Lidhur me kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimit objekt shqyrtimi.

Gjykata mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimit objekt shqyrtimi. Në kuptim të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", subjekti që kërkon pezullimin e një akti duhet të provojë prekjen e interesave shtetërorë, shoqërore ose të individëve si dhe pasojat e pariparueshme që do të sillte zbatimi i aktit. Gjykata nuk gjeti argumente bindëse për mundësinë e cenimit të interesave shtetërorë, shoqërorë ose të individëve si rrjedhojë e zbatimit të menjëhershëm të këtij vendimi. Për këtë arsye Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të vendimit nr.52, datë 14.01.2009 të Këshillit të Ministrave.

3. Lidhur me pretendimin se vendimi objekt shqyrtimi është në kundërshtim me nenin 11 të Kushtetutës.

Kërkuesi pretendon se vendimi, objekt i këtij gjykimi, cenon parimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, të drejtën e pronës, ekonominë e lirë të tregut dhe qarkullimin e lirë të mallrave, të mbrojtura nga neni 11 i Kushtetutës. Sipas kërkuesit, në këtë vendim parashikohet që vetëm lënda djegëse Diezel D2 e prodhuar nga shoqëria ARMO sh.a. në vendburimet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, mund të tregtohet pas datës 1 janar 2009 deri në datën 31 dhjetor 2009. Kërkuesi pretendon gjithashtu, se vendimi objekt shqyrtimi cenon këtë parim, pasi krijon një diskriminim në favor të produktit vendas të prodhuar nga shoqëria ARMO përsa i përket sasisë së squfurit të lejuar në lëndët djegëse që do të tregtohen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga data 1 janar 2009 deri në datën 1 janar 2012.

Gjykata e ka sqaruar gjerësisht konceptin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, të garantuar nga neni 11 i Kushtetutës. Sipas saj, kjo liri nënkupton kryesisht të drejtën për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, të drejtën për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individi, të drejtën për të zgjedhur një punë sipas preferencës etj. Kjo liri përfshin të gjitha të drejtat që lidhen me prodhimin, shpërndarjen ose konsumin e mallrave dhe të shërbimeve. Forma më e lartë e lirisë ekonomike nënkupton të drejtën e pronës, lirinë e qarkullimit të fuqisë punëtore, të kapitalit dhe të mallrave pa asnjë kufizim, se individi ka të drejtë të punojë, të prodhojë, të konsumojë dhe të investojë në çdo mënyrë që i pëlqen dhe kjo liri duhet të mbrohet nga shteti. Liria e veprimtarisë ekonomike përmban në vetvete shumë të drejta dhe liri, si: liria e biznesit ose aftësia për të krijuar dhe mbyllur një sipërmarrje, liria e tregtisë ose mungesa e barrierave lidhur me importimin dhe eksportimin e mallrave dhe shërbimeve, liria monetare si masë për të garantuar qëndrueshmëri të çmimit, liria fiskale mbi të ardhurat qoftë individuale, qoftë ndaj biznesit në mënyrë të veçantë, të drejtat e pronës si aftësi e individëve për të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende të lirë nga ndërhyrja e shtetit, liria e investimit dhe qarkullimit të lirë të kapitaleve, veçanërisht kapitalit të huaj, liria financiare dhe pavarësia nga kontrolli shtetëror, liria e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 19.03.2008).

Gjykata është shprehur gjithashtu, se liria e veprimtarisë ekonomike përmban edhe detyrimin e shtetit që, nëpërmjet ligjvënësit, të ndërhyjë në rregullimin e kësaj lirie. Ky detyrim për rregullim i ligjvënësit shprehet nëpërmjet nxjerrjes së normave konkrete juridike, me anë të të cilave synohet disiplinimi i ushtrimit të veprimtarisë së lirë ekonomike në sektorë apo fusha të caktuara. Vetëm shteti mund të arrijë të krijojë mjedisin e vërtetë dhe optimal për ushtrimin e kësaj lirie vetjake, prandaj ai duhet parë si rregullator që ka si qëllim mbrojtjen e tregut nga deformimet, që natyrshëm mund t'i mbart me vete zhvillimi i lirë i veprimtarisë ekonomike.

Gjykata ka sqaruar edhe kriteret në bazë të të cilave shteti mund të ndërhyjë për të rregulluar ushtrimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, sipas Kushtetutës. Ajo është shprehur se, nisur nga struktura e Kushtetutës, e veçanta e nenit 11, paragrafi 3 është se ai nuk është parashikuar në grupin e të drejtave dhe lirive të tjera, por në pjesën ku parashikohen parimet themelore mbi të cilat mbështetet organizimi dhe funksionimi i shtetit. Kushtetutbërësi ka preferuar ta konsiderojë lirinë e veprimtarisë ekonomike së pari, si parim bazë të sistemit ekonomik të Republikës së Shqipërisë.

Bazuar në standardet e interpretimit të shprehura më sipër, Gjykata vlerëson fillimisht ekzistencën ose jo të një kufizimi nga ana e vendimit objekt shqyrtimi. Më pas, Gjykata vlerëson nëse kufizimi i pretenduar është bërë sipas kritereve të përcaktuara shprehimisht në Kushtetutë.

Kushtetuta e Shqipërisë parashikon se kufizimet e lirisë ekonomike mund të bëhen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

Gjykata konstaton se vendimi i kundërshtuar duke lejuar tregtimin e të njëjtit produkt me sasi të ndryshme squfuri, duke lejuar tregtimin e një produkti nga shoqëria ARMO të ndaluar për operatorët e tjerë dhe, duke u imponuar subjekteve tregtare që janë anëtare të kërkuesit dhe që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me shumicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, të pajisura me "leje tregtimi të llojit A", blerjen e produktit Diezel D2 pranë një operatori të vetëm, nëse duan që këtë produkt të vazhdojnë të shesin, krijon në treg një monopol në favor të shoqërisë ARMO sh.a. dhe për pasojë cenon lirinë e importimit dhe eksportimit të mallrave dhe shërbimeve, duke kufizuar kështu lirinë e tyre ekonomike.

Siç është theksuar në mënyrë konstante nga Gjykata Kushtetuese (Shih vendimin nr.12, datë 28.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese) kufizimet e lirisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj. Gjykata e ka sqaruar edhe më parë kuptimin e shprehjes "vetëm me ligj". Shprehja "vetëm me ligj" ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, atëherë ky vlerësim është në diskrecion vetëm të Kuvendit dhe jo të organeve të tjera, përfshirë edhe Këshillin e Ministrave. Në këtë përfundim, arrihet edhe duke iu referuar fjalës "vetëm" që përmendin nenet 11/3 të Kushtetutës. Përdorimi i kësaj fjale nuk është e rastit, por për të treguar se

kufizime të tilla nuk mund të vendosen me ndonjë akt tjetër përveç ligjit. Gjykata Kushtetuese ka çmuar se shprehja "vetëm me ligj" referon në kompetencën e organit ligjvënës dhe nxjerrja e akteve të tjera për të rregulluar marrëdhënie të tilla, cenon kompetencat e këtij organi (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 20, datë 11.07.2006).

Sa më sipër Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se, vendimi objekt shqyrtimi vendos një kufizim të lirisë ekonomike, kufizim i cili në bazë të dispozitave kushtetuese mund të vendoset vetëm me ligj.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 11 të vendimit objekt shqyrtimi janë në kundërshtim me nenin 11 të Kushtetutës..

4. Lidhur me pretendimin se vendimi objekt shqyrtimi, është në kundërshtim me marrëveshjet ndërkombëtare.

Kërkuesi pretendon se vendimi objekt shqyrtimi, cenon parimin e ekonomisë së lirë të tregut dhe qarkullimin e lirë të mallrave, të mbrojtur nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, e zbatueshme në rastin konkret.

Në zbatim të nenit 131 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos për pajtueshmërinë e ligjeve dhe akteve normative me marrëveshjet ndërkombëtare.

Gjykata Kushtetuese vlerëson, nëse kufizimi i lirisë ekonomike, i vendosur nga vendimi objekt shqyrtimi, është në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Në bazë të kësaj marrëveshje e drejta e shtetit për të ndërhyrë në rregullimin e ushtrimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike njeh një kufizim të ri të përcaktuar në pikën 2 të nenit 33 të saj, i cili parashikon se, "Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, nuk vendosen kufizime sasiore të reja për importet ose eksportet, apo masa të reja me efekt të njëjtë me to, dhe as nuk bëhen kufizime të mëtejshme mbi ato ekzistuese në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë".

Në zbatim të dispozitës së mësipërme shteti mund të kufizojë ushtrimin e lirisë ekonomike për aq sa nuk krijohen kufizime të mëtejshme mbi ato ekzistuese në tregtinë ndërmjet Komunitetit Europian dhe Shqipërisë. Por edhe ky kufizim i kompetencës shtetërore gjen përjashtim në nenin 42 të kësaj marrëveshjeje i cili parashikon se "Kjo Marrëveshje nuk përjashton ndalimet apo kufizimet e importeve, eksporteve ose mallrave tranzit të justifikuara në bazë të moralit publik, politikave publike ose sigurisë publike; mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve ose bimëve; mbrojtjes së thesareve kombëtare me vlerë artistike, historike ose arkeologjike, ose mbrojtjes së pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare, ose të rregullave lidhur me arin dhe argjendin. Megjithatë, ndalime ose kufizime të tilla nuk përbëjnë diskriminim arbitrar ose kufizim të tërthortë në tregtinë ndërmjet palëve".

Gjykata vëren se legjislacioni i brendshëm shqiptar ndalon tregtimin e lëndës Diezel D2, ndërsa për lëndën Diezel D1 lejon tregtimin e saj në disa kushte cilësie të përcaktuara dhe të zbatueshme njëlloj për të gjithë operatorët. Vendimi objekt shqyrtimi, përbën një përjashtim ndaj këtij ndalimi duke lejuar vetëm tregtimin e lëndës djegëse Diezel D2 të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto të nxjerrë nga vendburimet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe duke lejuar tregtimin e lëndës Diezel D1 të prodhuar nga vendburimet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në kushte cilësie më të favorshme se ajo e importuar. Për rrjedhojë, vendimi objekt shqyrtimi, nëpërmjet përjashtimit që krijon ndryshon legjislacionin shqiptar, duke krijuar një situatë ndalimi të importeve për një produkt dhe duke favorizuar prodhimet e brendshme për një produkt tjetër.

Gjykata vëren se vendimi objekt shqyrtimi, duke ndryshuar rregullat ligjore mbi importin e lëndës djegëse Diezel D2 dhe tregtimin e lëndës djegëse Diezel D1, krijon kufizim total për importet e lëndës Diezel D2 dhe vështirëson tregtimin e lëndës djegëse Diezel D1 edhe nëse këto lëndë importohen nga vendet anëtare të Komunitetit Europian, duke kufizuar kështu tregtinë ndërmjet Komunitetit Europian dhe Shqipërisë.

Subjekti i interesuar pretendon se ky kufizim lejohet në zbatim të nenit 42 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se vendimi i kundërshtuar nuk është i marrë në zbatim të nenit 42 të sipërpërmendur, pasi subjekti i interesuar nuk paraqiti prova se vendimi objekt shqyrtimi është marrë në zbatim të rasteve të parashikuara në pjesën e parë të këtij neni dhe as mundi të argumentojë që ky vendim nuk përbën diskriminim arbitrar në tregtinë ndërmjet Komunitetit Europian dhe Shqipërisë.

Për sa më sipër, vendimi nr.52, datë 14.01.2009 i Këshillit të Ministrave është në kundërshtim me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, konkretisht me nenet 33 dhe 42 të saj. Si rrjedhojë Gjykata Kushtetuese vlerëson se, pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 11 të vendimit të mësipërm duhen shfuqizuar.

5. Lidhur me pretendimin se vendimi objekt shqyrtimi, është në kundërshtim me nenin 118 të Kushtetutës.

Kërkuesi pretendon se vendimi i Këshillit të Ministrave, i kundërshtuar, nuk respekton kriteret e nenit 118/1 të Kushtetutës sipas të cilit, aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e përcaktuara me Kushtetutë; dhe nenit 118/2, sipas të cilit, ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si edhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte. Sipas kërkuesit, nenet 8 dhe 9 të ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", në asnjë pjesë të tyre nuk i japin kompetencë Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte nënligjore për përcaktimin e subjekteve tregtare të privilegjuara dhe atyre të diskriminuara. Kërkuesi pretendon gjithashtu se, vendimi objekt shqyrtimi, ka tejkaluar delegimin legjislativ të bërë nga neni 10, pika 5, e ligjit nr.8897, datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".

Gjykata, më sipër, lidhur me pretendimin për kufizim të veprimtarisë së lirisë ekonomike është shprehur se kufizimi i kësaj lirie është bërë nga vendimi nr.52 datë 14.01.2009 i Këshillit të Ministrave, në kundërshtim me nenin 11 të Kushtetutës që parashikon se këto kufizime mund të bëhen vetëm me ligj. Bazuar mbi këtë qëndrim Gjykata e çmon të mbështetur legjitimimin e kërkuesit për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së vendimit objekt i shqyrtimit kushtetues, në lidhje me kriteret e nenit 118 të Kushtetutës.

Neni 118/2 i Kushtetutës parashikon: "Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjen që duhet rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte."

Gjykata e vlerëson të bazuar pretendimin e kërkuesit për cenim të nenit 118/1,2 të Kushtetutës, me arsyetimin se ligji nr.9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", nuk parashikon asnjë delegim legjislativ për nxjerrjen e akteve nënligjore dhe as e përcakton Këshillin e Ministrave si organin kompetent.

Neni 10, pika 5 e ligjit nr.8897, datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja" parashikon se "Prodhuesit, importuesit, eksportuesit, transportuesit dhe tregtuesit e lëndëve djegëse detyrohen t'i prodhojnë, t'i importojnë dhe t'i tregtojnë ato në përputhje me kërkesat e cilësisë, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit".

Pretendimi se është shkelur neni 118/1,2 i Kushtetutës, pasi vendimi i kundërshtuar është marrë në tejkalim të kompetencave të deleguara nga neni 10, pika 5 e ligjit nr.8897, datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja" vlerësohet nga Gjykata si i drejtë, pasi vendimi objekt shqyrtimi, në pikat 1, 2, 3, 4, 5, 8, 9 nuk përmban dispozita mbi cilësinë e lëndëve djegëse. Këto dispozita lejojnë përdorimin e një produkti dhe përcaktojnë kushtet e tregtimit të tij. Rrjedhimisht, këto pika të vendimit të mësipërm të Këshillit të Ministrave tejkalojnë delegimin legjislativ të bërë nga pika 5 e nenit 10 të ligjit nr.8897, datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".

Gjykata Kushtetuese vëren, në plotësim të interpretimit të kryer në vendimin nr.12, datë 28.04.2009 të saj, se nëse pikat 1, 2, 3, 4, 5, 8, 9 të vendimit objekt shqyrtimi do të kishin një lidhje të ngushtë me objektin e delegimit, atëherë kushtetutshmëria e tyre duhet pranuar në cilësinë e aksesorit, ose ndihmësit të domosdoshëm të dispozitave kryesore të marra në zbatim të një ligji që vendos kufizimin e një të drejte kushtetuese. Nga vetë karakteri i tyre aksesor, ose ndihmës, këto dispozita ndjekin fatin e dispozitave kryesore, ndihmëse të të cilave ato janë, dhe nuk mund të zbatohen në mungesë të tyre ose jashtë qëllimeve të tyre. Për këtë arsye, një dispozitë aksesore, e

cila mund të zbatohet në mënyrë të pavarur nga dispozita kryesore, objekt i delegimit, nuk mund të ketë karakterin ndihmës.

Gjykata vëren se vetëm pikat 7 dhe 11 të vendimit të kundërshtuar, edhe pse nuk përcaktojnë kritere të cilësisë së lëndëve djegëse, kanë karakterin e dispozitës ndihmëse pasi garantojnë zbatimin dhe respektimin e pikës 6 të vendimit që hyn në kuadrin e objektit të delegimit të nenit 10, pika 5 e ligjit nr.8897, datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se pikat 1, 2, 3, 4, 5, 8, 9 të vendimit objekt shqyrtimi, nuk kanë lidhje me delegimin ligjor të pikës 5 të nenit 10 të ligjit nr.8897, datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", e cila i mundëson Këshillit të Ministrave përcaktimin e cilësisë së lëndëve djegëse të tregtuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe me nenet 8 dhe 9 të ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

Kërkuesi hoqi dorë nga pretendimi për shfuqizimin e pikës 10 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.01.2009, objekt i këtij shqyrtimi kushtetues, prandaj Gjykata nuk e shqyrtoi këtë pretendim.

Si përfundim, në vijim të arsyetimit të mësipërm, Gjykata Kushtetuese vlerëson se vendimi i Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.01.2009 cenon parimet e sanksionuara nga nenet 11 dhe 118 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 33 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Komunitetin Europian.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131 shkronja "c", 132 dhe 134, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës, si dhe neneve 49 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të pikave 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 11 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.01.2009 "Për cilësinë e lëndës djegëse gazoil (diezel), të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto, të nxjerrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe të tregtuar për automjete rrugore e gjeneratorë".
- Rrëzimin e kërkesës për kërkimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Vladimir Kristo (kryetar), Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Sadushi,Admir Thanza, Sokol Berberi.

MENDIM PARALEL

Duke mbështetur pjesërisht shumicën në vendimin për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.01.2009 "Për cilësinë e lëndës djegëse gazoil (diesel) të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto, të nxjerrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe të tregtuar për automjete rrugore e gjeneratorë" (VKM nr.52), vetëm për nenin 118 pika 2, nuk pajtohemi me të në argumentet e përdorura për çështjet e tjera si më poshtë:

1. Në vendimin e saj shumica arrin në përfundimin se VKM nr.52, veç sa sipër, vjen në kundërshtim edhe me nenin 11 të Kushtetutës, si dhe me nenin 33 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me Komunitetit Europian (MSA). Sipas shumicës VKM nr.52 "duke lejuar tregtimin e një produkti nga shoqëria "ARMO", të ndaluar për operatorët e tjerë, dhe duke u imponuar subjekteve tregtare që janë anëtare të Shoqatës së Shoqërive të Hidrokarbureve që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me shumicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, të pajisura me leje tregtimi të llojit A, blerjen e produktit Diezel D2 vetëm pranë një operatori të vetëm, nëse duan që këtë produkt të vazhdojnë ta shesin, krijon një monopol në treg në favor të shoqërisë "ARMO" dhe për pasojë cenon lirinë e importimit dhe eksportimit të mallrave dhe shërbimeve, duke kufizuar kështu lirinë e tyre ekonomike". Dhe, meqenëse ky kufizim nuk është bërë me ligj, shumica e konsideron VKM nr.52 si të papajtueshem me nenin 11 të Kushtetutës.

2. Më tej shumica vlerëson se VKM nr.52 është i papajtueshëm edhe me nenin 33 të MSA sipas të cilës "që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, nuk vendosen kufizime sasiore të reja për importet ose ekportet, apo masa të reja me efekt të njëjtë me to dhe as nuk bëhen kufizime të mëtejshme mbi ato ekzistuese në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë". Shumica vëren se VKM nr.52, krijon kufizim total për importet e produktit Diezel D2 edhe nëse këto importe kryhen nga vendet anëtare të Komunitetit Europian, duke kufizuar kështu tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë.

3. Në kundërshtim me sa më sipër, ne mendojmë se nuk është VKM nr.52 që nëpërmjet normave të tij ka bërë një kufizim të lirisë ekonomike. Përkundrazi, ky kufizim është bërë më parë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.147, datë 21.03.2007 "Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzen dhe diesel" (VKM nr.147). Në këtë vendim, ndër të tjera thuhet se në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke filluar nga data 1 janar 2009 do të lejohet për përdorim në automjetet rrugore dhe gjeneratorët, vetëm tregtimi i lëndës djegëse diesel, e cila plotëson kërkesat e standardit shqiptar S SH EN 590 ose të standardeve të tjera të barasvlefshme me të (Diezel D1).

4. VKM nr.52 nuk bën gjë tjetër veçse lejon një përjashtim nga rregullat e vendosura më sipër vetëm për shoqërinë "ARMO" dhe vetëm për tregtimin e lëndës djegëse të prodhuar në rafineritë e vendit nga rafinimi i naftës bruto, të nxjerrë nga vendburimet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ky përjashtim nuk kufizon lirinë ekonomike për shoqëritë e tjera interesat e të cilave mbron kërkuesi, sepse këtë kufizim, siç u përmend dhe më sipër, e ka bërë VKM nr.147. "Pozitën dominuese" në treg për një shoqëri apo një tjetër e lejon ligji nr.9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (shih nenet 8 e vijuesa) dhe vetëm konstatimi i saj, në rastin e Shoqërisë "ARMO", nuk mund të përbëjë kufizim të lirisë ekonomike për të tretët. Edhe në qoftë se, në mënyrë hipotetike do të pranonim se ka një kufizim të lirisë ekonomike për shoqëritë e përfaqësuara nga kërkuesi, ky kufizim në rastin konkret është i përkohshëm dhe bëhet për arsye të rëndësishme publike që lidhen, veç të tjerash, edhe me shfrytëzimin racional të burimeve natyrore të vendit (neni 59 i Kushtetutës), mjafton që të kishte një autorizim nga ligjvënësi në ligjin nr.9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurencës". Për këto arsye, argumentet e përdorura nga shumica për të arritur në përfundimin se VKM nr.52 kufizon lirinë ekonomike dhe për rrjedhojë ai është i papajtueshëm me nenin 11 të Kushtetutës janë të pabazuara.

5. Për të njëjtat argumente, i pabazuar është vendimi i shumicës edhe kur konstaton papajtueshmërinë e VKM nr.52 me nenin 33 të MSA. Kjo e fundit në nenin 42 nuk përjashton vendosjen e ndalimeve apo kufizimeve të importeve, eksporteve ose mallrave tranzit të justifikuara në bazë të moralit publik, politikave publike ose sigurisë publike.

Për sa më sipër, jemi të mendimit se VKM nr.52 është i papajtueshëm vetëm me nenin 118 pika 2 të Kushtetutës për arsye se në asnjë nga nenet e tij, ligji nr.9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurencës", nuk autorizon nxjerrjen e akteve nënligjore dhe as nuk përcakton organin kompetent. Për rrjedhojë, referimi që bën VKM nr.52 në këtë ligj është i pabazuar dhe i paautorizuar prej ligjvënësit. Ndërsa referimi i VKM 52 në ligjin nr.8897, datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", ashtu si përmendet dhe në vendim, është i pabazuar, sepse VKM nr.52 nuk përmban dispozita mbi cilësinë e lëndëve djegëse.

Anëtarë: Admir Thanza, Vladimir Kristo (kryetar)

VENDIM
Nr.25, datë 24.7.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese
Gjergji Sauli	Anëtar	i "	"
Fehmi Abdiu	Anëtar	i "	"
Kujtim Puto	Anëtar	i "	"
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i "	"
Petrit Plloçi	Anëtar	i "	"
Vitore Tusha	Anëtare	e "	"
Sokol Sadushi	Anëtar	i "	"
Sokol Berberi	Anëtar	i "	"

me sekretare Blerina Çinari, në datë 25.11.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.25/11 Akti, që i përket:

KËRKUES: GRUPI NISMËTAR PËR ZHVILLIMIN E REFERENDUMIT, përfaqësuar nga Spartak Braho dhe av.Bledar Fejzo, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KOMISIONI QENDOR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Çlirim Gjata dhe Dëshira Pasko, me autorizim.

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj me autorizim.

OBJEKTI: a) Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.47, datë 5.06.2008 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

b) Interpretimi i nenit 150, pika 1 dhe nenit 177 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 124, 131, 134, 150 pika 1 e 3 dhe 177 të Kushtetutës; nenet 126, 127, 128 dhe 129 të ligjit nr.8609, datë 08.05.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Berberi; përfaqësuesit e kërkuesit, që kërkuan pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Kuvendit, që kërkuan rrëzimin e saj; u këshillua me mendimin "Amicus Curiae" të Komisionit të Venecies, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Më datë 29.05.2008, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) është paraqitur kërkesa e një grupi nismëtar prej 24 zgjedhësish për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi të përgjithshëm për shfuqizimin e neneve 5, 7 dhe 8 të ligjit nr.9904, datë 21.04.2008 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e RSH", të ndryshuar". Në kërkesën drejtuar KQZ-së kërkohet edhe pajisja me fletët tip për mbledhjen e nënshkrimeve të 50 mijë zgjedhësve.

2. KQZ-ja, me vendimin nr.47, datë 5.06.2008, vendosi mospranimin për shqyrtim të kërkesës së Grupit Nismëtar për Zhvillimin e Referendumit (Grupi Nismëtar). Në vendimin e KQZ-së arsyetohet, ndër të tjera, se kërkesa e paraqitur ka të bëjë me një "referendum kushtetues", sipas nenit 122 të Kodit Zgjedhor dhe jo me "referendum të përgjithshëm", parashikuar nga neni 126 i Kodit Zgjedhor. Si rrjedhojë, kërkesa u konsiderua se nuk është objekt shqyrtimi nga ky organ.

3. Grupi Nismëtar për Zhvillimin e Referendumit, më pas, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për "Shfuqizimin e vendimit të mësipërm të KQZ-së dhe interpretimin e nenit 150, pika 1 dhe nenit 177 të Kushtetutës".

Kërkuesi pretendoi se:

- Ky vendim i KQZ-së është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor si rezultat i të cilit është cenuar e drejta kushtetuese për zhvillimin e një referendumi. Arsyetimi i KQZ-së se grupi nismëtar kërkon mbajtjen e një referendumi kushtetues dhe se KQZ nuk është organi kompetent për shqyrtimin e kësaj kërkese, cenon rregullshmërinë e procesit ligjor.

- Kërkuesit i janë shteruar të gjitha mjetet juridike për realizimin e së drejtës për kryerjen e procedurave për referendum të përgjithshëm.

- Vendimi i kundërshtuar i KQZ-së është marrë në tejkalim të kompetencave të KQZ-së, të cilat i takojnë Gjykatës Kushtetuese.

- Grupi i individëve që paraqet këtë kërkesë, sipas kërkuesit, gëzon të drejta kushtetuese jo vetëm si subjekt i një procesi që rregullohet nga Kodi Zgjedhor, por potencialisht si mbrojtës i të drejtave thelbësore kushtetuese që rrjedhin nga neni 150 i Kushtetutës. Për këto arsye ai legjitimohet edhe për të kërkuar interpretimin e Kushtetutës sipas nenit 124 dhe 134/2 të Kushtetutës.

- Nenet 150 e 177 të Kushtetutës nuk bien ndesh me njëri-tjetrin, por rregullojnë procedura të ndryshme dhe garantojnë të drejta të ndryshme, nga njëra anë për Kuvendin e Shqipërisë (neni 2/2 i Kushtetutës) dhe nga ana tjetër, të popullit (neni 2/1 i Kushtetutës). Neni 177 i Kushtetutës rregullon procedurën për referendum kushtetues, që ka të bëjë me faktin se ky lloj referendumi kërkohet vetëm për miratimin apo ratifikimin e ndryshimeve kushtetuese të realizuara nëpërmjet procedurave parlamentare. Ky është një referendum konsultativ apo "konsultim popullor". Ushtrimi i drejtpërdrejtë i sovranitetit bëhet sipas nenit 150/1 të Kushtetutës.

Subjektet e interesuara, KQZ-ja dhe Kuvendi parashtruan se kërkesa duhet rrëzuar pasi:

- Kërkuesi nuk plotëson kushtet e kërkuara për legjitimimin. Grupi Nismëtar për Referendumin, nuk mund të konsiderohet, sipas nenit 134, pika 1, shkronja "f", "organizata të tjera". Në këtë kuptim, nismëtarët mund të konsiderohen vetëm sipas shkronjës "g" të nenit 134, pika 1 të Kushtetutës për të shpallur antikushtetues një vendim të KQZ-së pasi nuk na rezulton se janë shteruar të gjitha mjetet e ankimit.

- Vendimi i KQZ-së është në vetvete një akt administrativ, i cili realisht mund të ankimohet në gjykatën e juridiksionit të zakonshëm.

- Në Kodin Zgjedhor, në kreun e dytë, janë parashikuar tri lloje referendumesh: referendumi kushtetues, referendumi i përgjithshëm dhe ai vendor. Kërkuesit konfondojnë këtë ndarje duke kërkuar që referendumi kushtetues të konsiderohet si referendum i përgjithshëm.

- Sipas nenit 177 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese shqyrton paraprakisht kushtetutshmërinë e mbajtjes së referendumit kushtetues, kur një kërkesë e tillë ka ardhur në përputhje me nenin 177 të Kushtetutës nga të paktën 28 deputetë dhe në përputhje edhe me nenet 122, 123 dhe 124 të Kodit Zgjedhor dhe jo nga ndonjë subjekt tjetër.

- Sipas nenit 150 të Kushtetutës dhe nenit 129 të Kodit Zgjedhor, Gjykata Kushtetuese do të shqyrtonte kushtetutshmërinë e kërkesës për referendum të përgjithshëm vetëm në rastet kur, pas verifikimit të rregullshmërisë, kërkesa përcillet në Gjykatën Kushtetuese nga KQZ-ja.

- Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor kanë përkufizuar qartë referendumin kushtetues dhe subjektin që mund të kërkojë këtë referendum. Konfondimi që përpiqet të bëjë kërkuesi mes referendumit kushtetues dhe atij të përgjithshëm është në kundërshtim me nenet 150 dhe 177 të Kushtetutës, si dhe nenet 122-131 të Kodit Zgjedhor. Nenet 150 dhe 177 të Kushtetutës parashikojnë dy lloje të ndryshme referendumesh, të cilat rregullohen në mënyrë më të detajuar nga Kodi Zgjedhor.

- Kërkuesit nuk legjitimohen as për kërkesën e dytë për interpretimin e një ose disa neneve të Kushtetutës, pasi nuk përfshihen në subjektet e parashikuara nga neni 71 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

II

1. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ngriti pretendimin se kërkuesi nuk plotëson kushtet e kërkuara për legjitimimin, për arsye se Grupi Nismëtar për Referendumin, sipas shkronjës "g" të nenit 134, pika 1 të Kushtetutës, nuk rezulton t'i ketë shteruar të gjitha mjetet e ankimit për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së vendimit të KQZ-së; dhe, për kërkesën e dytë, lidhur me interpretimin e neneve 150 dhe 177 të Kushtetutës, nuk përfshihet në subjektet e parashikuara nga neni 71 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

2. Kërkuesi pretendon se bazuar në nenet 131, shkronja "f" dhe 134, shkronja "g" të Kushtetutës, ai legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sipas objektit të kërkesës, për arsye se i është cenuar e drejta kushtetuese për realizmin e procedurave për një referendum të përgjithshëm, ka shteruar të gjitha mjetet për realizmin e kësaj të drejte dhe se ky grup është, potencialisht, mbrojtës i të drejtave thelbësore kushtetuese që rrjedhin nga neni 150 i Kushtetutës.

3. Gjykata Kushtetuese (Gjykata), në jurisprudencën e saj, ka interpretuar kriteret kushtetuese për legjitimimin e subjekteve që mund ta venë atë në lëvizje sipas nenit 134, pika 2, të Kushtetutës. Individët janë përcaktuar në nenin 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Ata kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme, të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që duhet të ekzistojë ndërmjet interesit të tyre ligjor dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak (Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 26.02.2007; nr.11, datë 04.04.2007; nr.35, datë 10.10.2007; nr.41, datë 16.11.2007; nr.9, datë 19.03.2008). Për të vlerësuar legjitimimin e subjektit Gjykata, fillimisht, përcakton të drejtën kushtetuese të subjektit që pretendohet se është cenuar nga akti konkret i kundërshtuar para saj. Në çështjen në shqyrtim kërkuesi pretendon, se akti i kundërshtuar ka cenuar të drejtën kushtetuese për realizmin e procedurave për një referendum të përgjithshëm, bazuar në nenin 150 të Kushtetutës.

4. Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me një kërkesë objekti i së cilës është: "Për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm me objekt për shfuqizimin e neneve 5, 7, dhe 8 të ligjit nr.9904, datë 21.04.2008 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar". Kërkesa është bazuar në nenet 131, 134, 124, 150/1, 3 dhe 177 të Kushtetutës dhe në nenet 126, 127, 128, 129 të Kodit Zgjedhor (KZ).

5. Në nenin 150, pika 1 të Kushtetutës parashikohet: “Populli, nëpërmjet 50 mijë shtetasve me të drejtë vote, ka të drejtën e referendumit për shfuqizimin e një ligji, si dhe t’i kërkojë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë”. Kodi Zgjedhor (KZ) ka bërë dallimin e “referendumit kushtetues” nga “referendumi i përgjithshëm”. Sipas nenit 122 të KZ, “Referendumi kushtetues, sipas pikës 5 të nenit 177 të Kushtetutës, është referendumi që kërkohet nga një e pesta e deputetëve, për t’ia nënshtruar votimit popullor amendamentin kushtetues, të miratuar nga jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit”. Ndërsa referendumi i përgjithshëm është referendumi që mund të kërkohet nga pesëdhjetë mijë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve, për shfuqizimin e një ligji, në përputhje me pikën 1 të nenit 150 të Kushtetutës, si dhe me dispozitat e KZ (neni 126/1 i KZ). Kërkesa për fillimin e procedurave të referendumit të përgjithshëm paraqitet në KQZ nga një grup prej jo më pak se 12 nismëtarësh, të cilët janë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve (neni 126/2 i KZ).

6. Gjykata, për të vlerësuar interesin e kërkuesit në këtë kontroll kushtetues çmon se duhet t’i japë përgjigje pyetjes nëse neni 150 zbatohet ndaj ligjeve për rishikimin e Kushtetutës, me fjalë të tjera, nëse pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e popullit në rishikimin e Kushtetutës kufizohet në mundësitë e parashikuara nga dispozitat e veçanta të nenit 177 të Kushtetutës, apo kjo pjesëmarrje e drejtpërdrejtë mund të organizohet gjithashtu sipas parashikimeve të përgjithshme të nenit 150.

7. Gjykata çmon se bazuar vetëm në interpretimin literal të togfjalëshit “shfuqizim i ligjit”, nuk mund të nxirret kuptimi i qartë i normës kushtetuese të parashikuar në nenin 150 për shkak se termi “ligj” merr përmbajtje të ndryshme në dispozita të ndryshme të Kushtetutës. Kështu, në nenin 116, pika 1, bëhet një dallim i qartë midis Kushtetutës dhe “ligjeve”. Ndërsa në nenin 4, pika 2, deklarohet se “Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë”. Ky kuptim i ndryshëm i termit “ligj” konfirmohet dhe nga fakti se vetë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është miratuar me ligjin nr.8417, datë 28.10.1998. Gjithashtu, në rastin konkret, amendamentet kushtetuese, të cilat kërkuesi kërkon t’ia nënshtrojë referendumit, janë miratuar me ligjin nr.9904, datë 21.04.2008 “Mbi disa ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërsië”, i ndryshuar”.

8. Gjykata rithekson se çdo dispozitë e Kushtetutës duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese. Kjo, për arsye se të gjitha normat dhe parimet kushtetuese formojnë një sistem harmonik. Natyra e Kushtetutës, koncepti i kushtetutshmërisë, nënkupton që Kushtetuta nuk mund të ketë kontradikta të brendshme. Për pasojë, asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.2, datë 19.01.2005). Në këtë linjë duhet të interpretohen edhe dispozitat objekt shqyrtimi.

9. Lidhur me çështjen në shqyrtim, Kushtetuta ka rregulluar, në një pjesë të veçantë, procedurat për rishikimin e Kushtetutës (Pjesa e shtatëmbëdhjetë, neni 177). Për rrjedhojë, shqyrtimi i çështjes nëse neni 150 zbatohet gjithashtu ndaj ligjeve për rishikimin e Kushtetutës nuk mund të vlerësohet pa marrë në konsideratë dhe nenin 177 të Kushtetutës. Sipas këtij neni, një amendament kushtetues i miratuar, mund t’i nënshtrohet referendumit në dy raste: 1) kur vendosin dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit (neni 177/4); 2) kur kërkohet nga një e pesta e anëtarëve të Kuvendit (neni 177/5). Duke qenë se neni 177 i Kushtetutës së Shqipërisë është dispozitë e veçantë për ndryshimin e Kushtetutës duhet prezumuar se, ky nen, trajton në mënyrë të hollësishme mundësitë e organizimit të një referendumi kushtetues për një ndryshim të Kushtetutës. Nga kuptimi i nenit 177 del se, një amendament kushtetues nuk i nënshtrohet referendumit në mënyrë të detyrueshme, por vetëm në rastin kur e kërkojnë subjektet e përmendura më sipër. Neni 177 nuk parashikon të drejtën për të thirrur një referendum për shfuqizimin e një ndryshimi të Kushtetutës nga 50 mijë shtetas me të drejtë vote. Kjo do të thotë që, përfshirja e drejtpërdrejtë e popullit në procesin kushtetutëbërës mundësohet vetëm nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në Kuvend.

10. Gjykata thekson se Kushtetuta, si ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë, duhet të jetë një akt i qëndrueshëm. Stabiliteti i Kushtetutës është një veçori, e cila, së bashku me veçori të tjera të saj e bën rregullimin normativ kushtetues të ndryshëm nga rregullimi normativ i bërë me

akte ligjore të një fuqie më të ulët. Stabiliteti i Kushtetutës është një vlerë kushtetuese. Kjo garantohet nga një procedurë e vështirë dhe komplekse e amendimeve të Kushtetutës, e parashikuar nga neni 177 i Kushtetuës. Gjykata çmon se kjo qëndrueshmëri mund të dëmtohet nëse një amendament kushtetues, i miratuar me një shumicë prej dy të tretash dhe për të cilin nuk është kërkuar që t'i nënshtrohet referendumit nga subjektet e parashikuara në nenin 177 të Kushtetutës, mund të shfuqizohet nëpërmjet një referendumi të kërkuar nga 50 mijë zgjedhës. Kushtetuta ka krijuar hapësirë për pakicën e anëtarëve të Kuvendit, e përbërë prej një të pestës së anëtarëve të tij që në rastin kur nuk bie dakord me shumicën e anëtarëve prej dy të tretash për amendamentin kushtetues, të kërkojë që ky i fundit t'i nënshtrohet referendumit. Megjithatë Kushtetuta, në mënyrë të qartë nuk synon mbajtjen gjithmonë të një referendumi mbi ndryshimet e Kushtetutës, por e kushtëzon atë vetëm në ato raste kur konsensusi i gjerë politik mungon. Në këtë kuptim, neni 177 parashikon garanci të mjaftueshme për pakicat (një e pesta e anëtarëve) pa qenë nevoja t'i drejtohet parashkimeve të nenit 150 të Kushtetutës.

11. Sipas kërkuesit, ushtrimi i drejtpërdrejtë i sovranitetit të popullit nuk kushtëzohet nga vullneti i asnjë organi tjetër. Kur iniciohet një referendum i përgjithshëm për shfuqizimin e një ligji, pas plotësimit të anës formale e procedurale, asnjë organ nuk ka mundësinë për të "penguar" zhvillimin e këtij referendumi, sepse kjo bazohet në nenin 2 të Kushtetutës. Referendumi i përgjithshëm për shfuqizimin e një ligji kushtetues argumenton kërkuesi, nuk duhet të ngatërrohet me referendumin e organizuar sipas nenit 177, i cili është një referendum ratifikues, mbas një procesi amendimi. Neni 150 i Kushtetutës, po sipas kërkuesit, përcakton një garanci të përgjithshme të kontrollit të popullit mbi Kuvendin, të cilit i ka kaluar të drejtën e ushtrimit të sovranitetit. Të vetmet ligje, për të cilat populli i ka hequr të drejtën vetes për të ushtruar kontroll shfuqizues, janë ato të përmendura në nenin 151/2 të Kushtetutës.

12. Gjykata vëren se kërkuesi, për të mbështetur qëndrimin e tij, referohet në teorinë e sovranitetit popullor sipas së cilës populli nuk përballet me kufizime dhe as detyrohet nga parashikimet kushtetuese në ushtrimin e sovranitetit. Për rrjedhojë, populli i cili presupozohet të jetë pushteti themeltar, duhet të jetë i lirë në zgjedhjen e mënyrës së ndryshimit të Kushtetutës, veçanërisht nëse bëhet fjalë për mbajtjen e një referendumi nëpërmjet iniciativës popullore.

13. Gjykata thekson se në një shtet kushtetues, ideja e një pushteti, i cili nuk përballet me detyrime dhe kufizime që burojnë nga Kushtetuta, nuk mund të pranohet. Sovraniteti i popullit, i vendosur në kuadrin e një sistemi kushtetues e ligjor, nuk mund të ngatërrohet me pushtetin themelor dhe kërkesa për të ndjekur disa procedura të veçanta gjatë ushtrimit të tij është tërësisht në përputhje me sovranitetin popullor. Kushtetuta e Shqipërisë në mënyrë të qartë e ka lidhur ushtrimin e sovranitetit popullor me rregulla të veçanta. Është e vërtetë se në përputhje me nenin 2, pika 1 e Kushtetutës "sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i takon popullit". Por, ky deklarim nuk nënkupton ushtrimin e sovranitetit nga populli në mënyrë të pakushtëzuar. Siç Gjykata theksoi më sipër, një nen i Kushtetutës duhet të interpretohet në kontekstin e Kushtetutës si një e tërë dhe jo i izoluar. Paragrafi në vijim i të njëjtit nen deklaron se "populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërdrejt". Nga interpretimi literal dhe historik i këtij paragrafi Gjykata çmon, se kushtetutëbërësi ka shprehur një preferencë të qartë në favor të demokracisë përfaqësuese. Instrumentet e demokracisë direkte zenë vend në këtë vështrim, jo si pushtet konkurrues i organeve përfaqësuese, por si instrumente që mundësojnë mënjanimin e mungesës së veprimit nga ana e përfaqësuesve ose balancimin e kësaj mungese. Referendumi, si një nga instrumentet e demokracisë direkte, nuk përbën alternativë ndaj procesit ligjvënës të parlamentit. Ai nuk mundëson bërjen e ligjeve, funksion i cili u është ngarkuar ekskluzivisht ligjvënësve (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.31, datë 19.11.2003).

14. Sovraniteti i popullit është një parim shumë i përgjithshëm, i cili bëhet i zbatueshëm nëpërmjet dispozitave të veçanta të Kushtetutës dhe nuk mund të përdoret për përjashtimin e këtyre dispozitave. Gjykata çmon, se nenet 150-152 dhe 177 të Kushtetutës janë në harmoni me parimin e sovranitetit popullor siç parashikohet nga neni 2. Këto nene nuk vijnë në kundërshtim me parimin, por e konkretizojnë atë duke treguar masën në të cilën sovraniteti ushtrohet nga përfaqësuesit, drejtpërdrejt nga populli apo në mënyrë të kombinuar.

15. Bazuar në analizën e mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se Kushtetuta e Shqipërisë lejon thirrjen e një referendumi për amendamentet kushtetuese vetëm brenda kufijve të parashikuar nga neni 177. E drejta e 50 mijë shtetasve me të drejtë vote për të kërkuar shfuqizimin e një ligji, sipas nenit 150, nuk shtrihet në ligjet për rishikimin e Kushtetutës.

16. Për sa më sipër, Gjykata çmon se kërkuesi nuk legjitimohet për të kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.47, datë 5.06.2008 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Gjykatën Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131 shkronja "ë"; 134, pika 1, shkronja "g"; 150; 152 dhe 177 të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.47, datë 5.06.2008 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Kujtim Puto, Vitore Tusha
Anëtarë kundër: Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Sokol Sadushi. Sokol Berberi.

MENDIM PAKICE

Mendimi ynë është i kundërt me qëndrimin e mbajtur nga shumica në shqyrtimin e ankimit kushtetues me kërkues "Grupi Nismëtar për Zhvillimin e Referendumit" dhe me objekt: "1) Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.47, datë 05.06.2008 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; 2) Interpretimi i nenit 150 pika 1 dhe nenit 177 të Kushtetutës".

Shumica ka vendosur rrëzimin e kërkesës duke u bazuar në konkluzionin se kërkuesi nuk legjitimohet për të kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.47, datë 5.06.2008, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pasi ky vendim nuk cenon një interes legjitim të kërkuesit. Këtë konkluzion shumica e mbështet në përfundimin që ka arritur pas interpretimit të neneve 2, 150 dhe 177 të Kushtetutës, se e drejta e 50 mijë shtetasve me të drejtë vote për të kërkuar shfuqizimin e një ligji, sipas nenit 150, nuk shtrihet në ligjet për rishikimin e Kushtetutës.

Gjyqtarët në pakicë kanë të njëjtin qëndrim me shumicën përsa i përket kuptimit të neneve 2, 150 dhe 177 të Kushtetutës dhe përfundimit të arritur pas interpretimit të këtyre dispozitave, por ndahen për çështjen e legjitimimit të kërkuesit dhe kushtetutshmërisë së vendimit nr.47, datë 5.06.2008 të KQZ-së.

1. Lidhur me legjitimimin e kërkuesit

Kërkuesi pretendon se, bazuar në nenet 131, shkronja "f" dhe 134, shkronja "g" të Kushtetutës, ai legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sipas objektit të kërkesës, për arsye se i është cenuar e drejta kushtetuese për realizmin e procedurave për një referendum të përgjithshëm, ka shteruar të gjitha mjetet për realizmin e kësaj të drejte dhe se ky grup është, potencialisht, mbrojtës i të drejtave thelbësore kushtetuese që rrjedhin nga neni 150 i Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese është shprehur se individët, sipas nenin 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, e ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Ata kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme, të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që duhet të ekzistojë

ndërmjet interesit të tyre ligjor dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Në çështjen në shqyrtim, kërkuesi pretendon se akti i kundërshtuar ka cenuar të drejtën kushtetuese për realizimin e procedurave për një referendum të përgjithshëm, bazuar në nenin 150 i Kushtetutës.

Pakica vëren se kërkuesi i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me kërkesën që ka për objekt: "Për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm me objekt për shfuqizimin e neneve 5, 7 dhe 8 të ligjit nr.9904, datë 21.04.2008 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë"". Kërkesa është bazuar në nenet 131, 134, 124, 150 dhe 177 të Kushtetutës dhe në nenet 126, 127, 128, 129 të Kodit Zgjedhor. Sipas Kodit Zgjedhor (KZ) "referendum i përgjithshëm" është referendumi që mund të kërkohet nga pesëdhjetë mijë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve, për shfuqizimin e një ligji, në përputhje me pikën 1 të nenit 150 të Kushtetutës, si dhe me dispozitat e KZ (neni 126/1 i KZ). Kërkesa për fillimin e procedurave të referendumit të përgjithshëm paraqitet në KQZ nga një grup prej jo më pak se 12 nismëtarësh, të cilët janë zgjedhës të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve (neni 126/2 i KZ). Me vendimin nr.47, datë 5.06.2008, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur mospranimin për shqyrtim të kërkesës së grupit të 24 nismëtarëve. KQZ ka arsyetuar, ndër të tjera, se kërkesa e paraqitur ka të bëjë me një "referendum kushtetues" sipas nenit 122 të Kodit Zgjedhor dhe jo me "referendum të përgjithshëm", parashikuar nga neni 126 i Kodit Zgjedhor. Si rrjedhojë, KQZ konstatoi se kërkesa nuk është objekt shqyrtimi nga ky organ.

Pakica çmon se KQZ-ja, me vendimin e sipërpërmendur, ka cenuar të drejtën legjitime të kërkuesit për të kërkuar fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi të përgjithshëm. Kjo e drejtë e kërkuesit bazohet në pikën 1 të nenit 150 të Kushtetutës dhe nenit 126 të Kodit Zgjedhor. Grupi nismëtar, ka kërkuar të ushtrojë të drejtën e tij ligjore, duke kërkuar fillimin e procedurave për një referendum të përgjithshëm. Kodi Zgjedhor, në zbatim të nenit 150 të Kushtetutës, ka parashikuar rregulla të posaçme ligjore që nëpërmjet një grupi nismëtar prej 12 shtetasish, përmbush njëkohësisht edhe të drejtën kushtetuese të 50 mijë shtetasve për zhvillimin e referendumit. Interesi i grupit nismëtar, në këtë fazë në të cilën ndodhet çështja, është i përligjur. Nga ana tjetër, KQZ-ja, në këtë fazë të procesit, në kuptim të dispozitës përkatëse të Kodit Zgjedhor, ka të drejtë të vendosë për pranimin ose mospranimin e kërkesës, duke e bazuar vendimin mbi rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur dhe plotësimin e kritereve ligjore lidhur me kërkesat për fillimin e procedurave për referendum. Kushtetutshmëria e çështjes që do t'i nënshtrohet referendumit, sipas nenit 152 të Kushtetutës, nuk vlerësohet nga KQZ-ja, por nga Gjykata Kushtetuese në një fazë të mëvonshme. Për rrjedhojë, pakica vlerëson se kërkuesi ka interes në kuptim të nenit 134, pika 2 të Kushtetutës për të kërkuar kontrollin e kushtetushmërisë së vendimit nr. 47, datë 5.06.2008 të KQZ-së, që sipas tij e ka penguar fillimin e procedurës ligjore për realizimin e referendumit.

Subjekti i interesuar, Kuvendi, pretendoi se kërkuesi nuk plotëson kushtet e kërkuara për legjitimimin: Grupi nismëtar për referendumin, sipas shkronjës "g" të nenit 134, pika 1 të Kushtetutës, nuk ka shteruar të gjitha mjetet e ankimit për të shpallur antikushtetues vendimin e KQZ-së, objekt shqyrtimi, përpara se t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese. Vendimi i KQZ-së është në vetvete një akt administrativ, i cili realisht mund të ankimohet në gjykatën e juridiksionit të zakonshëm.

Pakica çmon se kërkuesi ka plotësuar kushtin e kërkuar nga neni 131, shkronja "f" të Kushtetutës për shterimin e të gjitha mjeteve juridike për mbrojtjen e të drejtës së tyre për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi të përgjithshëm. Kodi Zgjedhor nuk parashikon rregulla për ankimimin e vendimit të KQZ-së, kur ajo vendos mospranimin e kërkesës, sipas nenit 128 të KZ. Në nenin 129 parashikohet kompetenca e Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e kërkesës, pas verifikimit nga ana e KQZ-së të rregullsisë së kësaj kërkese, ndërkohë që sipas nenit 326, shkronja "c" të Kodit të Procedurës Civile, "nuk mund të ngrihet padi në gjykatë për…aktet administrative të cilat sipas Kushtetutës janë në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese." Pavarësisht se vendimi, objekt shqyrtimi, i marrë nga KQZ, ka elementet e një akti administrativ, shqyrtimi i vlefshmërisë së tij nuk mund të jetë objekt i juridiksionit të zakonshëm gjyqësor edhe për shkak të natyrës së çështjes së zgjidhur nga KQZ-ja. Ky organ ka rrëzuar kërkesën e një grupi nismëtar prej 12 shtetasish, duke vlerësuar kushtetutshmërinë e referendumit të kërkuar prej tyre, ndërkohë që

shqyrtimi i një çështje të tillë, sipas nenit 152 të Kushtetutës, përbën juridiksion kushtetues. Për rrjedhojë, pakica është e mendimit se nuk mund të shmangen nga juridiksioni i drejtpërdrejtë i Gjykatës Kushtetuese çështjet që lidhen me procedurat dhe kompetencat e organeve përkatëse të parashikuara nga Kodi Zgjedhor, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga neni 150 i Kushtetutës.

2. Lidhur me pretendimin se vendimi i KQZ-së është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor

Sipas nenit 42/1 të Kushtetutës dhe jurisprudencës tashmë të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe p.sh. në procese disiplinore administrative (Shih vendimin nr. 21, datë 1.10.2008, vendimin nr. 76/2002 të Gjykatës Kushtetuese). Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese kuptohet që, lista e proceseve ligjore ku gjen zbatim e drejta e procesit të rregullt ligjor, nuk është shteruar.

Në vendimet e saj, Gjykata Kushtetuese ka çmuar se çdo organ i pushtetit publik gjatë ushtrimit të funksioneve të tij kushtetuese e ligjore është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike që lidhen me procesin e rregullt, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Në vendimin interpretues nr.75, datë 19.04.2002, Gjykata Kushtetuese është shprehur për disa elemente të procesit të rregullt administrativ, si njohja paraprake e personit me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, si nëpërmjet dhënies së sqarimeve paraprake ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes. Gjithsesi Gjykata është shprehur se këto janë disa elemente bazë të procesit të rregullt ligjor, cenimi ose jo i të cilave vlerësohet rast pas rasti nga vetë Gjykata.

Kërkuesi pretendon se procesi i zhvilluar nga KQZ është i parregullt, pasi ky organ ka vepruar ne tejkalim të kompetencave që i jep ligji. Në përpjekje për të bërë një analogji ndërmjet elementeve të një procesi të rregullt ligjor me ato të një procesi të rregullt gjyqësor sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe 6 të KEDNJ, kuptimi i termit "gjykatë e caktuar me ligj" si element i procesit të rregullt gjyqësor mund të hedhë dritë mbi kuptimin e organit administrativ, i cili detyrohet të respektojë standardet e procesit të rregullt ligjor.

Gjykata, në jurisprudencën e saj ka interpretuar termin "gjykatë e caktuar me ligj" në shumë raste. Sipas saj, e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë "e caktuar me ligj" është element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Por e drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon gjithashtu që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë prej ligjit. Gjykata Kushtetuese i referohet GJEDNJ kur citon se "Një tribunal karakterizohet në kuptimin thelbësor të shprehjes nga funksioni i tij gjyqësor, me të cilin duhet kuptuar të vendosurit mbi çështjet brenda kompetencave të tij, bazuar në rregullimet ligjore dhe sipas procedurave të zhvilluara në mënyrë të përcaktuar (Shih vendimin e GJK 31/2005, i cili referon te vendimi i GJEDNJ "Belilos v. Zvicrës", dt.29.04.1988, Series A no. 132, § 64). Termi "ligj", në kuptim të nenit 6 § 1 të KEDNJ, përfshin në veçanti legjislacionin për krijimin dhe kompetencën e organeve gjyqësore (Shih vendimin e GJEDNJ Lavents v. Latvia, nr. 58442/00, § 114, 28 nëntor 2002). Rrjedhimisht, nëse një tribunal nuk ka juridiksion për të gjykuar një person në përputhje me dispozitat e së drejtës së brendshme, ai nuk është "krijuar me ligj" sipas kuptimit të nenit 6 § 1 (Shih çështjen JORGIC v. GERMANY, nr. 74613/01 vendim i 12 korrik 2007 , § 64). Gjykata më tej rithekson, se në parim, një shkelje e këtyre dispozitave ligjore për krijimin dhe kompetencën e organeve gjyqësore mund të lindë nje shkelje të nenit 6 § 1 (Çështja JORGIC, § 65).

Nga formulimet e mësipërme, koncepti i gjykatës së caktuar me ligj, lidhet qartazi me veprimin në përputhje me kompetencën e caktuar me ligj. Për analogji, çdo organ administrativ mund të konsiderohet se vepron në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe respekton të drejtën për një proces të rregullt ligjor nëse vepron në bazë, përputhje dhe brenda kompetencave që i jep ligji.

Mbi standarde të tilla niset pakica për të analizuar nëse, vendimi i KQZ-së objekt shqyrtimi, është një akt i kryer në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ato të Kodit Zgjedhor, apo është akt në tejkalim të kompetencave (*ultra vires*) dhe që mund të ketë cenuar standardet e një procesi të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës.

Neni 150, pika 1 e Kushtetutës parashikon se populli, nëpërmjet 50 mijë zgjedhësve, ka të drejtën e referendumit për shfuqizimin e një ligji, si dhe t'i kërkojë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë. Neni 150, pika 3 parashikon se parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendumit, si dhe vlefshmëria e tij parashikohen me ligj. Lidhur me referendumet, në bazë të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese ka dy kompetenca : njëra në bazë të nenit 131 shkronja "ë" dhe tjetra në bazë të nenit 152. Sipas nenit 131, shkronja "ë", Gjykata Kushtetuese vendos për kushtetueshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij pasi ky referendum është kryer. Në bazë të nenit 152, Gjykata Kushtetuese shqyrton paraprakisht kushtetueshmërinë e çështjeve të shtruara për referendum sipas nenit 150, pika 1 e 2 (për referendumin e përgjithshëm), nenit 151, paragrafët 2 e 3 dhe sipas nenit 177 paragrafët 4 e 5 (për rishikimin e Kushtetutës) brenda 60 ditëve. Gjykata në këtë rast vihet në lëvizje nga subjektet që legjitimohen para Gjykatës sipas parashikimeve të nenit 134 të Kushtetutës dhe të Kodit Zgjedhor.

Çështja e referendumeve, përveç Kushtetutës, rregullohet nga dispozitat përkatëse të Kodit Zgjedhor (KZ), pjesa e pestë. Kreu i dytë i kësaj pjese bën dallimin ndërmjet referendumeve kushtetuese, të përgjithshme vendore dhe parashikon procedurat përkatëse (nenet 118-128 të KZ). Më konkretisht, neni 126 i KZ-së mbi nismën për referendum të përgjithshëm e përdor fjalën "kërkesë" për të kuptuar " kërkesën për referendum nga 50 mijë zgjedhës"; "kërkesën për fillimin e procedurave të referendumit". Neni 128 përshkruan me hollësi verifikimin e kërkesës nga KQZ. Neni 128 paragrafi 2 i Kodit Zgjedhor qartëson se KQZ-ja vendos për pranimin ose mospranimin e kërkesës brenda 90 ditëve nga data e paraqitjes së saj, duke e bazuar vendimin vetëm mbi rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur. Fjalia pasuese e nenit se "ky vendim duhet t'u njoftohet nismëtarëve" lë të kuptojë që fjala "kërkesë" përfshin edhe "kërkesën për fillimin e procedurave të referendumit". Normat e përcaktuara në nenet 126 dhe 128, nisur nga interpretimi literal, e kufizojnë hapësirën e vlerësimit të KQZ-së lidhur me kërkesën për të filluar një referendum të përgjithshëm vetëm në çështjen nëse janë plotësuar kriteret e nenit 126, pika 4 për fillimin e procedurave për referendum.

Ndonëse Kodi Zgjedhor i njeh KQZ-së autoritetin për të pranuar kërkesat për ushtrimin e së drejtës për referendum, si çdo dispozitë ligjore që kufizon të drejta edhe kjo duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtë. Gjykata Kushtetuese është shprehur më parë për rëndësinë dhe instrumentin e referendumit si mjet kushtetues i lidhur me nocionin e sovranitetit të popullit (neni 2/1 i Kushtetutës), që ushtrohet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur prej tij ose në mënyrë të drejtpërdrejtë (neni 2/2). Çështja e përcaktimit të kushteve dhe rasteve, në të cilat populli mund ta ushtrojë sovranitetin në mënyrë të drejtpërdrejtë, merr një rëndësi themelore (Shih vendimin e GJK nr. 31, datë 19.11.2003). Nga ky këndvështrim, kompetenca e KQZ-së për shqyrtimin e kërkesës për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit interpretohet se duhet ushtruar në mënyrë strikte dhe brenda kufijve që përcaktojnë nenet 126 dhe 128 të Kodit Zgjedhor.

Neni 129 i KZ parashikon se KQZ-ja pasi verifikon rregullsinë e kërkesave, ia përcjell kërkesat për referendum të Përgjithshëm Presidentit të Republikës dhe Gjykatës Kushtetuese. Këto kërkesa KQZ-ja duhet t'ia dërgojë për vlerësim Gjykatës Kushtetuese, dhe është kjo e fundit që vendos paraprakisht për kushtetueshmërinë e kërkesave për referendum të përgjithshëm nga pikëpamja e çështjeve që shtrohen në kërkesë. Gjykata Kushtetuese paraprakisht mund të shprehet nëse kërkesa e paraqitur kualifikohet sipas nenit 150 apo sipas nenit 177 të Kushtetutës. Më pas Gjykata Kushtetuese ushtron kompetencën ekskluzive dhe shprehet paraprakisht për kushtetueshmërinë e çështjeve që shtrohen për referendum në përputhje me parashikimet e nenit 152 të Kushtetutës.

Vendimi i KQZ-së, objekt shqyrtimi para Gjykatës Kushtetuese, në pjesën arsyetuese të tij përmban vlerësime rreth kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi, të cilat për nga përmbajtja janë drejtpërdrejt interpretime që lidhen me

kushtetueshmërinë e çështjeve që shtrohen për referendum. Kështu p.sh. KQZ-ja shprehet se "Kushtetuta e RSH ..parashikon ushtrimin e drejtpërdrejtë të sovranitetit të popullit nëpërmjet referendumit…Kushtetuta parashikon disa lloje referendumesh…" "në rastin konkret jemi para një kërkese për referendum kushtetues" etj. Nga analiza e pjesës arsyetuese të vendimit të KQZ-së rezulton se në disa paragrafë KQZ-ja del përtej vlerësimeve që ajo duhet të bënte sipas neneve 126 dhe 128 të Kodit Zgjedhor, i cili i kërkon të vendosë për pranimin ose mospranimin e kërkesës nga data e paraqitjes së saj duke e bazuar vendimin vetëm mbi rregullsinë e dokumentacionit.

Mbi bazën e kësaj analize kushtetuese pakica konkludon, se vendimi nr.47, datë 5.06.2008 i KQZ-së është rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor për shkak të tejkalimit të kompetencave që i ka caktuar ligji këtij organi.

Anëtarë: Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Fehmi Abdiu

VENDIM
Nr.27, datë 27.7.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar	i "	"
Petrit Plloçi	Anëtar	i "	"
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i "	"
Vitore Tusha	Anëtar	i "	"
Sokol Sadushi	Anëtar	i "	"
Sokol Berberi	Anëtar	i "	"
Admir Thanza	Anëtar	i "	"
Kujtim Puto	Anëtar	i "	"

me sekretare Blerina Çinari, në datë 24.03.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.34/19 Akti, që i përket:

KËRKUES: AVOKATURA E PËRGJITHSHME E SHTETIT, përfaqësuar nga Abaz Deda, me autorizim.

Ergys Kadiu, Klodian Kadiu, Hysen Zhegu, përfaqësuar nga avokat Dashamir Kore, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:Hasan Mema, përfaqësuar nga avokat Vasil Plaku, me prokurë.

Agim Zhegu, Sulejman Çollaku, Haneme Çollaku, Fatbardha Çollaku, Nurie Çollaku, Agim Çollaku, Liljana Çollaku, Arta Çollaku, Arbër Çollaku, në mungesë.

ZYRA VENDORE E AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE TË QARKUT TIRANË, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr.752, datë 16.02.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.799, datë 7.07.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i vendimit nr.00-2006-256 (770), datë 2.06.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f e 134 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesit e kërkuesve që kërkuan pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjektit të interesuar Hasan Mema, që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimet nr.683, datë 3.09.1994 dhe nr.61, datë 11.10.1999, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë ka njohur si ish-pronar trashëgimlënësin Sulejman Zhegu në një sipërfaqe trualli prej 15.000 m^2 dhe u ka kthyer trashëgimtarëve të tij Hysen Zhegu dhe Agim Zhegu një sipërfaqe trualli prej 6669 m2.

Subjekti i interesuar Hasan Mema, duke pretenduar për të drejtën e tij të pronësisë mbi sipërfaqet e mësipërme, ka kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë anullimin e vendimeve të mësipërme të Komisionit. Meqenëse trashëgimtarët e Sulejman Zhegut kishin tjetërsuar 5000 m^2 nga sipërfaqja e truallit të kthyer nga Komisioni te subjektet e tjera të interesuara Ergys Kadiu dhe Klodian Kadiu, këta të fundit u thirrën si persona të tretë në gjykim, ku u shqyrtua edhe pavlefshmëria e kontratës me të cilën ata kishin blerë truallin nga trashëgimtarët e Sulejman Zhegut.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.752, datë 16.02.2005, vendosi pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë, anulimin e vendimit nr.683, datë 3.09.1994 të KKKP Tiranë, njohjen pronar të subjektit të interesuar Hasan Mema në sipërfaqen prej 15.000 m^2, kthimin dhe kompensimin e kësaj prone trashëgimtarëve të këtij të fundit, si dhe konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së shitblerjes. Me këtë vendim është vendosur gjithashtu anulimi pjesërisht i vendimit nr.684, datë 03.09.1994 të Komisionit, me të cilin ishte vendosur kthimi trashëgimlënësit Haxhi Çollaku të një sipërfaqeje tjetër trualli, prej 1070m^2, pronë shtetërore, e ndodhur në zonën ku palët janë në mosmarrëveshje dhe kalimin e saj në pronësi të subjektit të interesuar.

Mbi ankimin e kërkuesit Hysen Zhegu dhe të subjekteve të interesuara Ergys Kadiu dhe Klodian Kadiu, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.799, datë 7.07.2005, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë ka ushtruar rekurs Avokatura e Shtetit, ashtu dhe kërkuesit e tjerë Hysen Zhegu, Ergys Kadiu e Klodian Kadiu.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2006-256 (770), datë 02.06.2006, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura.

Vendimet e mësipërme i kanë kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese si Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, ashtu dhe kërkuesit e tjerë Hysen Zhegu, Ergys Kadiu e Klodian Kadiu. Duke qenë se objekti i kërkesave ka të bëjë me të njëjtin gjykim ku kërkuesit kanë qenë palë dhe objekte të njëjta apo të lidhura ngushtë midis tyre, Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 1 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" dhe në nenin 448 të Kodit të Procedurës Civile vendosi që të bashkojë kërkesat në një proces të vetëm gjykimi kushtetues.

Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, duke pretenduar se gjykatat e sistemit gjyqësor kanë zhvilluar një proces të parregullt ligjor, ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimeve të mësipërme:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka dalë jashtë juridiksionit gjyqësor, për arsye se ka vendosur jo vetëm anulimin e vendimit të Komisionit, por dhe dhënien e truallit subjekteve të interesuara Mema, kur kjo e fundit i takon juridiksionit administrativ.

- Bazuar në aktekspertimin që ka bërë eksperti i ngarkuar nga gjykata e rrethit, madhësia e ish-pronës që i është njohur Sadik Memës është 46.500 m^2. Marrja përsipër nga gjykata e azhurnimit të këtyre pronave me anë të një aktekspertimi, i cili nuk është bërë nga ana e specialistëve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, ka shkaktuar pasoja si për palët në gjykim, ashtu dhe për shtetin.

- Nuk është njoftuar për gjykimin në shkallë të parë e në apel dhe nuk i janë dërguar aktet e gjykimit, duke i cenuar të drejtat kushtetuese për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur para gjykatës.

Kërkuesit, Ergys Kadiu, Klodian Kadiu dhe Hysen Zhegu parashtruan këto shkaqe për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të mësipërme:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka cenuar standardin e zhvillimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi e njëjta gjyqtare dhe i njëjti ekspert kanë marrë pjesë në një gjykim të mëparshëm, objekti i të cilit kishte lidhje të ngushtë me çështjen në gjykim dhe që ka përfunduar me miratimin e pajtimit me vendimin gjyqësor nr.2519, datë 5.06.2003 të asaj gjykate.

- Gjykata ka cenuar standardin e zhvillimit të një gjykimi të drejtë, pasi vendimet nuk mbështeten në të dhënat që ndodhen në akte dhe që janë shqyrtuar në seancë gjyqësore. Gjykata nuk ka analizuar të gjitha provat e ndodhura në akte, por vetëm ato të subjektit të interesuar Hasan Mema, duke i çmuar ato në mënyrë të njëanshme.

- Rekurset e paraqitura në Gjykatën e Lartë kanë ngritur shkaqe që provonin mosrespektim dhe zbatim të gabuar të ligjit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ajo e Apelit Tiranë. Vendimi i Gjykatës së Lartë për moskalimin e çështjes në seancë gjyqësore vjen në kundërshtim me qëndrimet e mbajtura nga Gjykata Kushtetuese sipas të cilave, për problemet e legjitimimit, të kompetencës, të cenimit të së drejtës së mbrojtjes etj., duhet të jepet përgjigje në seancë gjyqësore dhe jo në dhomën e këshillimit.

Subjekti i interesuar Hasan Mema parashtroi këto prapësime:

- Në gjykimin në apel, Avokatura e Shtetit ka dhënë vlerësimin e saj për gjykimin në shkallë të parë dhe është shprehur për rrëzimin e padisë.

- Në çështjen në gjykim, nuk parashtrohet asnjë pretendim për pronë shtetërore, por kundërshtohen dy akte administrative (vendimet e KKKP), të cilat kanë njohur si ish-pronarë dhe kanë kthyer në favor të kërkuesve sipërfaqe tokash. Në këtë kuptim, nuk bëhet fjalë për "mbrojtjen e interesave të shtetit" përderisa, në të dy vendimet e kundërshtuara, Avokatura e Shtetit pranon humbjen e pronësisë së shtetit.

- Në bazë të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, subjekti i interesuar legjitimohet të kërkojë në gjykatë jo vetëm anulimin e vendimit të Komisionit, por edhe kthimin e truallit, pasi Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk mund të revokojë vendimet e tij. Legjitimimi i subjekteve për të kundërshtuar vendimet e Komisionit përbën tashmë një praktikë të konsoliduar gjyqësore, e cila është pranuar edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me Vendimin Unifikues nr.25, datë 28.03.2003.

II

1. Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, Avokatura e Shtetit ka pretenduar se gjykata e rrethit ka marrë kompetencat që u takojnë organeve të administratës shtetërore, sepse sipërfaqet e trojeve nuk duhej të ktheheshin me vendim të gjykatës, por me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Sipas saj, gjykata duhej të vendoste vetëm për vendimin e Komisionit, dhe jo të kthente në natyrë të truallin, objekt mosmarrëveshjeje, subjektit të interesuar Hasan Mema.

Subjekti i interesuar Hasan Mema pretendoi se legjitimohej të kërkonte në gjykatë edhe kthimin e pronës, sepse ishte cenuar nga vendimi i Komisionit dhe se ky i fundit nuk mund të revokojë vendimet e tij. E drejta e çdo individi për t'iu drejtuar gjykatës për të kërkuar kthimin e pronës së marrë me vendim të Komisionit dhe zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes prej saj, përbën një praktikë të konsoliduar gjyqësore.

Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) sqaron, se çështjen e kompetencës ajo e ka parë të lidhur me standardin kushtetues të "gjykatës së krijuar me ligj", element ky i procesit të rregullt ligjor dhe i parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Përcaktimi i saktë i kompetencës është detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës sipas të cilit, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Megjithatë Gjykata thekson se bazuar në nenin 7 të Kushtetutës që sanksionon jo vetëm ndarjen, por dhe balancimin e pushteteve dhe në aktet normative që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të këtij parimi, pushteteve të tjera u është njohur e

drejta/kompetenca për të zgjidhur çështjet ose mosmarrëveshjet që kanë lidhje me funksionet e tyre.

Parimi i shtetit të së drejtës kërkon gjithashtu që veprimtaria e organeve të administratës publike të rregullohet jo vetëm me ligj, por edhe që kjo veprimtari, në raport me të drejtat e shtetasve, t'i nënshtrohet kontrollit gjyqësor. Prandaj, sipas nenit 42 të Kushtetutës, individi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës edhe kur cenimi i të drejtave, i lirive dhe i interesave kushtetues e ligjorë të tij ka ardhur nga akti apo veprimtaria e organeve të administratës publike.

Njohja, kthimi dhe kompensimi i pronës bëhet nëpërmjet një organi administrativ mbi kërkesën që ish-pronari u drejton organeve përkatëse të administratës publike. Sipas nenit 27/a të ligjit nr.7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", nëse individi kërkues nuk është dakord me vendimin e Komisionit, ai ka të drejtë ta kundërshtojë këtë vendim drejtpërdrejt në gjykatë. Vendimet e organeve të administratës ka të drejtë t'i kundërshtojë në gjykatë, përveç kërkuesve, edhe çdo person tjetër që pretendon për vete të drejta pronësie. Legjitimiteti i këtyre subjekteve, si pjesë e praktikës së zakonshme gjyqësore, është pranuar dhe nga Gjykata e Lartë, që sipas nenit 141/2 të Kushtetutës ka bërë njësimin e praktikës gjyqësore.[1] Gjatë gjykimit të iniciuar prej subjekteve të mësipërme, përveç të tjerave, hetohet dhe vërtetohet dhe fakti nëse këtyre subjekteve u është cenuar apo jo e drejta e pronësisë dhe, çdo vendim gjykate që do të anullonte pjesërisht ose plotësisht vendimet e organit përkatës së administratës, duhet të konfirmojë njëkohësisht edhe të drejtën e tyre të pronësisë. Prandaj, Gjykata Kushtetuese çmon se kur shqyrtohet një mosmarrëveshje e inicuar nga të tilla subjekte, gjykata ka juridiksion dhe kompetencë jo vetëm që të anulojë pjesërisht ose plotësisht vendimet e organit administrativ, por njëkohësisht edhe të njohë e të kthejë pjesërisht ose plotësisht pronën në favor të tyre. Megjithatë, shqyrtimi i një mosmarrëveshjeje të tillë duhet të kufizohet vetëm në pronën që është objekt i vendimeve të organit administrativ dhe jo të shtrihet në prona të tjera që nuk janë objekt i këtyre vendimeve pasi, siç u parashtrua më sipër, njohja, kthimi dhe kompesimi i pronës i takon fillimisht juridiksionit administrativ, ndërsa gjykata, me ankesë të individit, shprehet mbi kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e vendimit të organeve të administratës, pasi ato të kenë marrë vendimin përkatës. Në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata arrin në përfundimin se kthimi i drejtpërdrejtë i pronës nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në rastet kur ajo shqyrton ankesat ndaj vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk përbën tejkalim të juridiksionit gjyqësor. Do të kemi një tejkalim të tillë në rastet kur gjykata jep vendim për të drejta pronësie mbi sipërfaqe që nuk janë kërkuar dhe nuk janë marrë më parë në shqyrtim nga organi administrativ. Në raste të tilla gjykata merr kompetencat e këtij të fundit, duke cenuar parimet e shtetit të së drejtës e të ndarjes së pushteteve.

2. Kërkuesit pretenduan gjithashtu, se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë i ka mohuar Avokaturës së Shtetit të drejtën për të përfaqësuar shtetin në gjyq, sepse jo vetëm nuk e ka njoftuar atë për gjykimin e çështjes, por nuk i ka dërguar asaj as aktet e gjykimit për t'i krijuar mundësinë reale për t'u dëgjuar e mbrojtur në gjykatën e rrethit dhe në gjykatën e apelit.

Subjekti i interesuar Hasan Mema ka argumentuar se kërkuesit kanë bërë mbrojtjen e tyre në gjykatën e apelit. Sipas tij, shteti nuk kishte ndonjë interes të ligjshëm e si rrjedhojë, nuk i është cenuar e drejta e mbrojtjes në gjyq.

Gjykata Kushtetuese ka pranuar se e drejta për të qenë i pranishëm në gjykim është pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Kjo e drejtë i ngarkon autoritetet me detyrat që të njoftojnë, në kohë të mjaftueshme, palët dhe mbrojtësit e tyre për datën dhe vendin e mbajtjes së procedurave gjyqësore, për të kërkuar praninë e tyre dhe për të mos i përjashtuar ata padrejtësisht nga gjykimi. Kjo është tashmë një praktikë e njohur dhe e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese dhe e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut sipas së cilës do të ishte pavlerë përshkrimi në detaje i garancive procedurale të palëve në proces në rast se atyre nuk do t'u sigurohej ajo që në fakt bën të mundur respektimin e këtyre të drejtave dhe që është pjesëmarrja në gjykim (Shih vendimin nr.11, datë 18.05.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

[1] *Vendimet nr.25, datë 28.03.2003 dhe nr.2, datë 06.01.2009 të Gjykatës së Lartë.*

Sipas ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" dhe ligjit të kohës nr.8551, datë 18.11.1999 "Për Avokaturën e Shtetit", përfaqësimi dhe mbrojtja e pronës dhe interesave publikë nga ana e Avokaturës së Shtetit, në një gjykim të filluar, është një përfaqësim dhe mbrojtje e detyrueshme dhe gjykatat, sipas nenit 79/a të Kodit të Procedurës Civile, kanë detyrimin që t'i njoftojnë aktet Avokaturës së Shtetit me qëllim që jo vetëm të ketë mundësi të marrë pjesë në gjykim, por edhe të realizojë mbrojtjen e interesave të shtetit.

Në çështjen në shqyrtim, gjykatat, shqyrtuan pretendimet e palëve për pozicionet e paqarta të trojeve dhe pronësinë e tyre. Ndër të tjera, ato vendosën të kalojnë në pronësi të subjektit të interesuar Hasan Mema edhe sipërfaqen prej 1070 m^2 që nuk ishte disponuar nga vendimet e Komisionit në favor të kërkuesit apo të Avokaturës së Shtetit. Përderisa kishte pretendime nga secila palë për pronësinë mbi këtë sipërfaqe dhe përderisa përcaktimi i pozicionit të saj kishte lidhje me përcaktimin e pozicionit të trojeve të tjera, gjykatat duhet të vlerësonin pretendimet e të gjitha palëve, duke njoftuar e duke ia dërguar aktet e gjykimit edhe Avokaturës së Shtetit, e cila, sipas nenit 1, pika 3 të ligjit nr.8551, datë 18.11.1999 "Për Avokaturën e Shtetit", ushtron përfaqësimin në gjyq pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit.

Subjekti i interesuar ka pretenduar gjithashtu se mosthirrja e Avokaturës së Shtetit në gjykimin e shkallës së parë nuk përbën një shkelje të së drejtës për proces të rregull ligjor, për shkak se Avokatura e Shtetit ka realizuar të drejtën e mbrojtjes në gjykimin e shkallës së dytë.

Në jurisprudencën e Gjykatës është pranuar se gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi si i tërë ka qenë i rregullt, duke u ndaluar në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces. Në vendimet e veta Gjykata nuk ka pranuar cenimin e parimit për një proces të rregullt ligjor në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës, ka plotësuar apo ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor (Shih vendimin nr.21, datë 1.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese). Por, në rastin në shqyrtim, nuk rezulton që gjykatat e sistemit gjyqësor të kenë plotësuar standardet e gjykimit, sidomos në dhënien e mundësive Avokaturës së Shtetit për të siguruar mbrojtjen e interesave publikë. Kjo e fundit nuk është njoftuar e nuk i janë dërguar aktet për gjykimin në shkallë të parë dhe në këtë mënyrë i është mohuar një shkallë gjykimi për të paraqitur prova, për të dëgjuar pretendimet e palës tjetër e për të bërë prapësimet e duhura ndaj aktit të ekspertimit. Sipas pretendimit të përfaqësuesit të Avokaturës së Shtetit, kjo e fundit nuk kishte dijeni as për gjykimin në apel dhe, pjesëmarrja e punonjëses së saj në këtë gjykim ishte rastësore. Por, edhe sikur të ishin dërguar rregullisht kopjet e akteve të gjykimit dhe të ishte njoftuar rregullisht për gjykimin në apel, pjesëmarrja e Avokaturës së Shtetit nuk do të mund të realizonte një mbrojtje efektive, të riparonte mangësitë themelore procedurale që kishin të bënin me mosnjoftimin e pjesëmarrjen e palëve, mosrespektimin e juridiksionit dhe kompetencën etj., të cilat gjykata e apelit, sipas nenit 467 të Kodit të Procedurës Civile, nuk mund t'i korrigjojë vetë, dhe për këtë arsye është e detyruar të prishë vendimin e gjykatës së shkallës së parë e ta dërgojë çështjen për rigjykim.

Pretendimin e shkeljes së juridiksionit gjyqësor dhe të mosnjoftimit të akteve Avokatura e Shtetit e ka ngritur dhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, e cila nuk e ka kaluar çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore. Lidhur me këtë, Gjykata Kushtetuese ka pranuar në vendimet e veta, se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, prandaj Gjykata e Lartë duhet të mbante një qëndrim të shprehur për të (Shih vendimin nr.41, datë 29.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

Për sa më sipër, Gjykata çmon se në këtë aspekt ka pasur cenim të parimit kushtetues të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor.

3. Në lidhje me pretendimin e kërkuesve Ergys Kadiu, Klodian Kadiu dhe Hysen Zhegu për cenimin e standardit kushtetues të zhvillimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, Gjykata Kushtetuese konstaton, se kryetarja e trupit gjykues dhe eksperti kanë marrë pjesë, duke shfaqur mendim, në një çështje që ishte e lidhur dhe e ndërvarur pazgjidhshmërisht me çështjen në shqyrtim dhe ku zgjidhja e të parës, në lidhje me pozicionin e trojeve, mund të ndikonte edhe në çështjen ku kërkuesit ishin palë. Duke respektuar parimin e paanësisë ata ishin të detyruar që të hiqnin dorë nga

gjykimi i çështjes në shqyrtim. Megjithatë, Gjykata konstaton, se kërkuesit nuk kanë kërkuar përjashtimin e tyre gjatë gjykimit të shkallës së parë, si dhe nuk kanë ngritur pretendimin e cenimit të standardit kushtetues të gjykimit nga një gjykatë e paanshme gjatë gjykimit në shkallët e tjera të çështjes. Në këto kushte Gjykata vëren se kërkuesit, për këtë pretendim nuk kanë shteruar mjetet ligjore për mbrojtjen e së drejtës së tyre, kërkesë kjo e nenit 131/f të Kushtetutës, dhe si i tillë ai nuk mund të përbëjë shkak për shfuqizimin e vendimeve të gjykatave.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.752, datë 16.02 2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; të vendimit nr.799, datë 7.07.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr.00-2006-256 (770), datë 2.06.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Kujtim Puto, Admir Thanza
Anëtarë kundër: Xhezair Zaganjori, Sokol Sadushi, Petrit Plloçi, Sokol Berberi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë

Hyri në shtyp më 20.8.2009
Doli nga shtypi më 22.8.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 44 lekë